

“JO” e referendumit do ta zbrazë Maqedoninë

Fq.4



KOMISIONI EVROPIAN

Frikë se mund të humbin vendet e punës

Fq.4



BE po mbërrin në pikën e shpërbërjes

Fq.12



# Koha

www.koha.mk

Shqetësimi për kufirin

Fq.15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3469 · e mërkurë, 26 shtator 2018

6°C | 17°C

15 DEN

EDITORIAL

“Ujemi” i informimit gjysëm të verifikuar



Të ndodhur në kurthin e lajmeve të rrejshme, lexuesit dhe shikuesit e mediave e kanë vështirë të marrin një qëndrim të prerë rreth zhvillimeve këtu afër nesh por edhe më larg. Si rast studimi madje mund të merret debati për “korigjimin e kufijve”, që u inicua fillimisht nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe i zgjeruar pastaj nga politikanë e gazetarë të shumtë. Mundësia për të rrëshqitur në terrenin e dezinformatës...

Fq.2

AKTUALE

Prindërit paguajnë, fëmijët mbesin pa libra

Fq.7

AKTUALE

Tetova s’ka interesim për shtëpi të pleqve

Fq.9



SHPËRNGULJE MASIVE E FUQISË PUNËTORE

## EDHE BERBERËT PO IKIN NË KURBET



Statistikat tregojnë se Gjermania regjistron gjithnjë e më shumë punëtorë të huaj. Vetëm në tetë muajt e parë të vitit të kaluar, Agjencia Federale e Punës ka lëshuar leje pune për 63.000 persona vetëm nga Ballkani Perëndimor. Ekziston kërkesa e madhe në ndërtimtari, hoteleri, shërbime mjekësore, pastrues, kujdestar për personat e vjetër, kopshtar..., madje edhe berberë

Fq.7

## Kush do t’i mbajë pensionistët?

Shkup, 25 shtator - Trendet e ndryshimeve demografike të viteve të fundit do të pasqyrohen negativisht në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit në dekadat e ardhshme. Rritja e shkallës së varësisë së moshës, e cila në Maqedoni është shumë më poshtë sesa mesatarja e BE do të krijojë pas disa vitesh një situatë të atillë ku numri i punëtorëve që do të duhet të ‘punojnë’ për të mbajtur një pensionist do të jetë

edhe më i vogël, që nënkupton se barra financiare mbi popullsinë e aftë për punë do të jetë më e madhe. Alarmi jepet nga Enti Shtetëror i Statistikave, sipas të cilit në dhjetë vitet e ardhshme do të vihen në pikëpyetje qëndrueshmëria e financave publike, fondeve pensionale dhe tërë sistemi i sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore. Kjo për shkak se popullsia që po plaket është duke ushtruar një...

Fq.5



## EDITORIAL

# “UJEMI” I INFORMIMIT GJYSËM TË VERIFIKUAR



Emin AZEMI

Të ndodhur në kurthin e lajmeve të rrejshme, lexuesit dhe shikuesit e mediave e kanë vështirë të marrin një qëndrim të prerë rreth zhvillimeve këtu afër nesh por edhe më larg. Si rast studimi madje mund të merret debati për “korrigjimin e kufijve”, që u inicua fillimisht nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe i zgjeruar pastaj nga politikanë e gazetarë të shumtë. Mundësia për të rrëshqitur në terrenin e dezinformatës janë shumë të mëdha, kurse ndërtimi i qëndrimeve precize politike gati i pamundshëm.

Kur një debat zhvillohet në kufijtë e konspiracionit, është i determinuar të prodhojë më shumë konfuzitet se sa qartësi mendimi. Burimet e afërta me presidentin Thaçi, megjithatë e kanë të qartë se çka po ndodhë, mirëpo kjo nuk mjafton që të krijohet një ide më e qartë mbi i temën për të cilën po diskutohet. Në rrethana të tilla jo pak faktorë politikë, por edhe përfaqësues të mediave e të shoqërisë civile në Kosovë, sikur janë të prirur t’u besojnë më tepër lajmeve të rrejshme se sa burimeve të mirëinformuara. Rivaliteti i brendshëm politik dhe dualizmi i vetë përmbajtjes së këtij debati, ka lënë të hapur shumë shtigje për kauza publike e të fshehta, për ide të reja e ambicie të vjetra dhe për ballafaqime në mes të historisë dhe gjeografisë.

Çka ka mundur gazetaria të bëjë më shumë në kushtet kur politika është jotransparente? Në radhë të pare, mediat nuk kanë mundur ta mbajnë të mbyllur debatin në suaza të ekspertëve të mirëfilltë, për arsye se ndërkohë për “korrigjim kufijsh” kanë folur dhe po flasin turlu personi që (mos) njohjen me problemin e kanë shndërruar në dilema (personale) hamletiane “të jesh a mos t’ë jesh”. Pastaj, natyra e problemit nuk ka duruar improvizime redaktoriale të mediave, duke hedhë në publik teza që jo gjithmonë kanë nxitur interaksion në mes të dijes dhe politikës, në mes të transparencës dhe diskrecionit. Për pasojë, ky debat po i ngjan një lavjerrësi që mban pezull peshën e një problemi me amplituda të skajshme, ku mungojnë pllakëzat kryesore të mozaikut: qëndrimi zyrtar i Uashingtonit e Brukselit dhe përgjigja përfundimtare e Beogradit.

Një medie tregohet e pafuqishme të japë përgjigje për dilema të caktuara vetëm nëse e merr rolin që nuk i takon. Me fjalë të tjera, një medie kur shndërrohet në qendër ku matet fuqia politike e oponentëve e ka vështirë të bëjë diferencimin në mes të informacionit dhe qëndrimit. Në raste të tilla përgjegjësit e atyre mediave bëjnë punën e komisarëve për lidhje, ndërkohë që publikut i mbetet të ushqehet nga “ujemi” i informimit gjysëm të verifikuar.

Debati për “korrigjimin e kufijve” përveç atraksionit mediatik, ka nxitur edhe fantazinë politike për një temë që teknikisht mund të konsiderohet e pambyllur, por tash më e rumbullakësuar nga aspekti i negociatave e marrëveshjeve jotransparente. Produkti final i kësaj teme pritet të bëhet publik shumë shpejt, me gjithë intensitetin e saj të befasisë dhe traumës publike.

## PADRONËT E HERONJVE

“Sot para kohe po ngritim përmendore. Secilën po e ngrit padroni i heroit. Jo për ta ngrit heroin, por për të u ngrit përmes heroit.

I tejkaluan fazat nga padituria. Harruan se përmendoret janë faza e fundit e shtetit. Nëse i kanë kaluar fazat e para, atëherë këto shtete paskan qenë afatshkurtër.

Por jo. Nuk është aty puna. Puna është që të ngriten heronj të gjallë përmes atyre që ranë për liri. Të gjallë, sepse secili ka ndarë heroin e vet andaj komandanti do që edhe në varr ta komandoj.

E ju që për moment të fundit të jetës patet istikamin, por nuk patët padronin, ju prisni tek Zoti titullin e heroit. Më mirë do të ju bjerë”, shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti nga Kumanova, Sead Ramadani.



## SHBA PO DËMTON RËNDË MIQËSINË ME SHQIPTARËT!

Donald Trump dhe Departamenti i Shtetit, NË RAST se edhe DE JURE e stimulojnë (politikisht), përkrahin (mediatist) dhe e faktorizojnë (diplomatikisht) idenë e COPËTIMIT të Kosovës, ATA, ad acta jo vetëm që do e shfuqizojnë gjeopolitikën rajonale të balancave që u krijua në vitin 1999, por definitivisht do e dëmtojnë e kompromitojnë skajshmërisht besimin, miqësinë dhe aleatin më të dëshmuar historikisht në Ballkan- atë shqiptar!

Për gjithë këtë ‘skenan hipotetik apokaliptik’, për Kosovën dhe faktorin shqiptar në Ballkan, NUK e fajësoj Uashingtonin e as Brukselin, por, injorancën, hipokrizinë dhe mendjelehtësinë e KASTËS POLITIKE KOSOVARE, që për dy dekada të tëra “miqësinë” me Amerikën e ndërtoj në premisa të gabuara (shkaku i krimit dhe korrupsionit kulminant); e keqkuptoj (shkaku, se menduan që shtetësinë dhe demokracinë duhet të ua ndërtojnë tjerët); e kompromitoj (shkaku se u vetëkënaq me improvizimin e shtetndërtimit); Në fakt, NËSE vërtetë ndodhë ky presedan (e me Donald Trump, po shihet se gjithçka është e mundur) në politikën e jashtme amerikane, shqiptarë e shekullit XXI atëherë, duhet t’u përshtatën rrethanave të reja; gjeopolitike e gjeostrategjike, në mënyrë që Projektin e faktorizimit të tyre në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ta kërkojnë gjetiu... Ose, thënë edhe më thjeshtë duhet ta aktivizojnë nga ‘xhepi Planin B”, shkruan në profilin e tij, sociologu nga Kosova, Fadil Maloku



## ERDOGANI, KRISHTI DHE FLORIRI

“Gazeta gjermane ‘Frankfurter Allgemeine Zeitung’ raportonte para pak javësh se, për ta përballuar krizën e fundit, Turqia e Erdoganit kishte shitur në 10 javë 118 tonë flori me vlerë rreth 6 miliardë dollarë, nga rezervat e saj të përgjithshme prej 594 ton flori me vlerë rreth 30 miliardë dollarë.

Edhe një shkrim i gazetës ‘IL SAPERE E’ POTERE’ thotë se Kisha Katolike Romane e Vatikanit kontrollon afërsisht 60.350 ton ar, dy herë më shumë se rezervat zyrtare të arit të gjithë vendeve të botës, afërsisht 30,2% të të gjithë arit të nxjerrë/prodhuar deri tani. Sipas vlerave të tanishme, kjo përbën thesarin më të madh në historinë njerëzore, me vlerë 1.245 miliard dollar amerikanë. Ta kishte ditur Krishti se kështu shkon puna, sigurt nuk do kishte ik prej kësaj dynjaje aq shpejt”, shkruan në profilin e tij, dr.Artan Dika.



## MEDIACitate

GRABAR KITAROVII  
IA KUJTON THAÇIT  
BADINTERIT PËR  
KUFIJTË

Presidentja e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitarović është deklaruar pas takimit me Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, në New York, me të cilin bisedoi në lidhje me dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës, ku Thaçi ia kujtoi “parimin e Komisionit të Badinterit që kufijtë në territorin e ish-Jugosllavisë duhet të mbesin të gdhendur në gurë”.

“Ishte interesante të flisja me presidentin e Kosovës, Thaçin, për marrëdhëniet mes Beogradit dhe Prishtinës dhe për temën që po dëgjohet së fundmi rreth mundësisë së shkëmbimit të territoreve. Këtu, ne jemi shumë të kujdesshëm dhe i kam treguar argumentet dhe qëndrimet tona si dhe faktin e parimit të Komisionit të Badinterit që kufijtë e ish-Jugosllavisë duhet të mbeten të gdhendura në gurë”, ka thënë presidentja Grabar-Kitarović, raporton Hina. Sipas agjencisë kroate të lajmeve, Hina, thekson se Grabar-Kitarović është takuar edhe me sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, Antonio Guterres, me të cilin “ka ndarë shqetësimin rreth situatës në Europën Juglindore në lidhje me proceset e rëndësishme që do të pasojnë brenda një kohe të shkurtër”.

“Ishte një takim shumë produktiv. Vlerësoj faktin se ai në këto ditë do të ketë 128 takime dhe jemi pajtuar se do të vazhdojmë dialogun. Ndamë shqetësimet për gjendjen në Europën Juglindore, proceset që do të hapen në të ardhmen, duke filluar nga zgjedhjet në Bosnje e Hercegovinë dhe faktin se nuk ka ndryshuar ligji i zgjedhjeve, nëpërmjet bisedimeve mes Beogradit e Prishtinës, deri në pritjen e rezultateve të referendumit të Maqedonisë për emrin e shtetit”, ka thënë Grabar-Kitarović.

(Hina, 25 shtator)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## KUSH ISHTE JOSIF RELA?

Josif Rela (1895-1966) ishte dramaturg dhe poet arbëresh nga Zara (Jugosllavi). Pasi kreu shkollën normale punoi si mësues. Veprimtarinë letrare e nisi në vitet ‘20. Shkroi në të folmen e Arbëneshit drama, komedi dhe vjersha. Josif Rela i këndoi gjuhës dhe zakoneve arbëreshe, bëri thirrje që të ruheshin traditat e

të parëve, shprehu pakënaqësinë ndaj realitetit të kohës. Vepra e tij më e shquar është drama “Nita” me subjekt shpërnguljen e arbëreshëve prej Shqipërisë në shek.XVIII. Në melodramën “Martesa” pasqyrohet jeta e arbëreshëve me doket karakteristike. Krijimtaria letrare e Josif Relës u botua kryesisht në shtypin e Kosovës.

Vetëm grupi i Afrim Gashit të Lëvizjes BESA ka zgjedhur Komunën e Çairit të mbyllin fushatën për referendumin, të gjitha partitë tjera shqiptare - BDI, PDSH, Lëvizja BESA dhe Aleanca për Shqiptarët kanë zgjedhur Tetovën për takimet përmbyllëse

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 25 shtator - Të enjten në mesnatë mbyllet fushata për referendumin për çështjen emrit me Greqinë, ndërsa më pas - të premten dhe të shtunën, do të ketë heshtje parazgjedhore. Të dielën më 30 shtator në ora 7 të mëngjesit do të nisë votimi për të mbaruar në ora 19. Të shtunën më 29 shtatorë, mundësi të votimit në referendum do të kenë personat e sëmurë, të burgosurit dhe personat e dënuar me burg shtëpiak. Por të parët që do të realizojnë të drejtën për votim janë anëtarët e Këshillave zgjedhor edhe atë në një vendvotim në Komisionin Shtetëror Zgjedhor.

Janë 104 anëtarë dhe zëvendës-anëtarë të këshillave, të cilët pas votimit do të udhëtojnë për në përfaqësitë diplomatike konsullore, dhe përfaqësitë konsullore të Maqedonisë, ku të shtunën më 29 shtatorë do të mbahet votimi për referendumin. Votimi jashtë vendit do të mbahet në 33 përfaqësi konsullore, dhe zyra konsullore në Republikën e Maqedonisë, përderisa për votim janë paraqitur 2694 shtetas të Maqedonisë. Shtetasit e Maqedonisë do të mund të votojnë në përfaqësitë konsullore në Bern, Lubjanë, Vjenë, Toronto, Londër, Bon, Hagë, Berlin, Melburn, Kanbera, Bruksel, Stokholm, Paris, Rim, Kopenhagë, Uashington, Detroit, Pragë, Abu Dabi, Beograd, Podgoricë, Ankara, Athinë, Bukuresht, Stamboll dhe Budapest. endet në të cilat janë paraqitur më së shumti votues janë Berni me 321, Venecia me 264, Ljublana 217, si dhe Vjena dhe Toronto me 151. Më pak se 10 votues janë paraqitur në Budapest, në Stamboll, Bukuresht dhe Athinë. Përderisa ndonjë votues, i cili paraprakisht është paraqitur se do të votojë në Konsullatë udhëton për në Maqedoni, nuk do të mund ta realizojë të drejtën e tij për votim në vend, pasi që emir i tij do të jetë i shënuar në vendin që është paraqitur. Votimi në diasporë fillon nga ora 7 e mëngjesit dhe përfundon në orën 19 sipas kohës lokale.

Ndryshe gjithsej 669 vëzhgues do ta ndjekin referendumin më 30 shtator 383 vëzhgues të brendshëm dhe 286 të huaj. Më së shumti vëzhgues të brendshëm ka të ak-

GJITHSEJ 669 VËZHGUES NDJEKIN REFERENDUMIN

# NË TETOVË PËRMBYLLIN FUSHATËN



redituar "Civil - Qendra për Liri" - 282, Qendra Nationale Rome Kumanovë 46 dhe Inkuziv 40, ndërkaq "Most" do të ketë 12, ndërkaq Shoqata "EDULS" 3 vëzhgues. OSBE/ODIHR do të ketë 188 vëzhgues, Ambasada e SHBA-së 35, ndërkaq misioni i OSBE-së në Shkup 12 vëzhgues. Asambleja e parlamentit të këshillit të Evropës do ta ndjekë referendumin me 8 vëzhgues, Ambasada e Britanisë së Madhe do të ketë 2, Ambasada e Francës, Shqipërisë dhe Hungarisë nga 6, e Turqisë dhe Kosovës me nga 4, Fondacioni për Sisteme Zgjedhore - IFES dhe Komiteti për Demokraci të hapur me nga 3, ndërkaq 2 vëzhgues do të ketë organizata joqeveritare The Earth Saviours Foundeishën. Për ndjekjen e referendumit janë akredituar edhe 47 gazetarë.

Ndryshe partitë politike në pushtet, edhe partitë shqiptare në opozitë do të mbajnë tubime përmbyllëse. Aleanca për Shqiptarët të enjten në Tetovë do të mbyll fushatën për referendumin me moton "Për BE dhe NATO". Po në Tetovë, por një ditë përpara (të mërkurën) në Shtëpinë e Kulturës në ora 19 e 30 do të mbyllë fushatën edhe Lëvizja BESA që me moton "Por për BE dhe NATO, si shqiptare jo si përqindje". Grupi i Afrim Gashit nga Lëvizja BESA do të mbyll po të enjten në Komunën

e Çair në sallën e sporteve "Shaban Tërstena, në ora 19 e 30. Ndërsa partia më e madhe në pushtet BDI fushatën do ta përmbyll në Tetovë të enjten në. Kryetari i PDSH-së, Menduh Thaçi, tha se me anëtarësimin në NATO do të eliminohen barrierat që maqedonasit i kanë vënë shqiptarëve.

"Bashkimi Evropian dhe NATO garanton një zhvillim përtej ekonomik të kombit shqiptar, ky integrim për shkak se NATO nuk është vetëm organizate ushtarake, është organizatë me standarde të definiuar. Ky integrim përmjetëherë do t'i eliminojë të gjitha barrierat artificiale që kanë vendosur maqedonasit mes neve dhe shqiptarëve tjerë dhe ne të gjithë do të punojmë bashkë, do të bëjmë biznese bashkë, do të kemi kapitalin e përbashkët dhe këtu do të zhvillohem të gjithë së bashku ekonomikisht. Unë besoj në angazhimin tonë drejt kësaj rruge, ka edhe të tjerë që natën veprojnë kundër, ndërsa ditën duken se janë pro", tha Menduh Thaçi.

Ndërkaq për referendumin 30 shtatorit, Thaçi ceku se është mundësia e parë dhe e fundit për integrim në NATO dhe BE. "Për ne 30 shtatori është mundësia e parë dhe ndoshta edhe e fundit, ne duhet të flasim shumë hapur me të gjithë shqiptarët. Ne atë ditë vëllezër në rrugën që marrim drejt

NATO-s dhe Bashkimit Evropian gjeneratave të reja u mundësojmë liri, demokraci dhe zhvillim, ndërsa rruga tjetër është rruga e shkatërrimit, rruga e luftës, rruga e vrasjeve dhe rruga e cila të çon në shkatërrim të plotë", kështu tha lideri i Partisë Demokratike Shqiptare në fjalimin e tij në takim me banorët e Tetovës. Për të ardhme të ndritur të shqiptarëve nëse anëtarësohemi në NATO foli edhe kryetari i Lëvizjes BESA Bilall Kasami.

"Duke votuar PËR më 30 shtator, rruga drejt NATO-s dhe BE-së do të jetë shumë më e lehtë dhe me këtë, do të kemi një të ardhme të ndritur. Të votojmë pro që të jemi të barabartë edhe në kushtetutë dhe të mos llogaritemi më si përqindje, por si shqiptarë, ashtu siç e kemi edhe sloganin për këtë fushatë Referendumit", tha kryetari Bilall Kasami. Ai vuri theksin tek rastet e montuara, të cilët me anëtarësimin në NATO, siç tha Kasami, nuk do të përsëriten në Maqedoni.

"Mesazhi i Lëvizjes Besa është shumë i qartë. U bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve që bashkërisht të angazhohemi në suksesin e plotë të Referendumit si proces dhe me këtë të dëshmojmë se populli, janë meritoret e ndryshimeve historike që do ta bëjnë Maqedoninë anëtare të NATO-s dhe BE-së", tha Kasami.

## Marrëveshja e Prespës, gjëja më e mirë që mundej të arrihet

Athinë, 25 shtator - Marrëveshja e Prespës është e mirë edhe për të dyja palët, e madje edhe politikanë të cilët publikisht janë kundër e pranojnë se nuk mundej të arrihet diçka më e mirë, thotë për MIA-n gazetari nga televizioni shtetëror ERT, Fanis Papatanasiu, i cili shumë vite e ndjek kontestin me emrin, ndërsa më 5 korrik ka realizuar intervistë me kryeministrin e Maqedonisë Zoran Zaev. Në bisedën me korrespondentën e MIA-s nga Athina, Papatanasiu komenton se marrëveshja ishte arritur përmes një procesi të vështirë, pas negociatave të mëdha, dhe me shumë mundim dhe dramë edhe nga të dyja palët, për shkak të reagimeve dhe polarizimit të popullit. "Konsideroj se marrëveshja është e mirë edhe për Greqinë edhe për Shkupin. madje nëse dikush bisedon me politikanë të partive siç janë Demokracia e Re dhe Grekët e Pavarur të cilët merren me çështjen, e dinë dhe e ndjekin çështjen, do të pranojnë se është marrëveshje e mirë edhe ata vetë të ishin në Qeveri do ta bënin të njëjtën. Nuk do të bënin diçka më ndryshe, por konsiderojnë se rezultati është një marrëveshje shumë e mirë që askush nuk do të mund të arrihte diçka më të mirë se kjo në këto rrethana", thotë Papatanasiu. Gazetari i ERT-së zbulon se në të gjithë procesin, që nga fillimi rol të rëndësishëm kanë luajtur amerikanët, por edhe udhëheqësit politikë të të dyja vendeve, si dhe shefat e diplomacive, ashtu edhe në nivel të kryeministrave. "Filloi një dinamikë, ndërsa element thelbësor ishte pjekuria dhe lidhshipin politik që e treguan të dy kryeministrat. Por, edhe guximim që e shprehën për të shkuar përpara drejt një procesi që të zgjidhet çështja e cila i mundon me dekada edhe rajonin edhe marrëdhëniet midis dy vendeve. Lidhur me reagimet në Greqi për Marrëveshjen Papatanasiu komenton se kanë qenë të pritura, ndërsa ai personalisht ka prituri ata të jenë më të fuqishme dhe më intensive, ndërsa protestat më të mëdha. Në prag të referendumit tek ne, gazetari me përvojë nga ERT, në bisedën për MIA-n shprehu shpresë se të dielën, rezultatet do të jenë pozitive dhe shtoi se nëse procesi i paraparë përfundon me sukses nga ana e Maqedonisë, marrëveshja do të ratifikohet edhe në Parlamentin grek.

## CIVIL-i ME 200 VËZHGUES

Më shumë se 200 vëzhgues vendorë të akredituar të CIVIL - Qendrës për liri do të ndjekin referendumin më 30 shtator. Siç kumtoi CIVIL, tashmë kanë shpërndarë mbi 30 vëzhgues aktivë afatgjatë nëpër tërë vendin, detyra e të cilëve është vëzhgim i procesit të zbatimit të përgatitjeve të referendumit në disa aspekte, ndërsa veçanërisht në aspektin e respektimit të së drejtës së votës. Monitorimi i CIVIL-it, siç theksojnë, është jopartiak, objektiv dhe neutral, ndërsa raportet nga puna në

terren janë në dispozicion në platformën mediatike të organizatës. Qëndrimet dhe analizat botohen në rubrika të ndryshme të platformës mediatike dhe jo çdoherë përputhen me qëndrimet e CIVIL-it. Nga Qendra apelojnë se si në proceset e kaluara zgjedhore, votuesit të shfrytëzojnë të drejtën e votës, lirshëm dhe pa frik dhe paragjykim. Çdo formë të presionit apo të kërcënimit të raportojnë tek CIVIL në ueb faqen Zgjedhje të lira apo në telefonin: 070 461 480 dhe 02 5209 176.

Çdo qytetar ka të drejtë të shprehet lirshëm në referendumin e ditës së diel, por Maqedonia në BE do të ishte shumë më stabile se sa jashtë BE-së që njehërit do të thotë qasje më të madhe deri te kreditë e lira si dhe treg stabil për import dhe eksport

INVESTITORËT E HUAJ ME POROSI TË QARTË

# “JO” E REFERENDUMIT DO TA ZBRAZË MAQEDONINË

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 25 shtator - Njëmbëdhjetë vitet e fundit nga Maqedonia kanë ikur mbi gjysëm milioni qytetarë sidomos të rinjtë dhe nëse më 30 shtator qytetarët e Maqedonisë bojkotojnë apo shumica e tyre votojnë me “JO” do kemi ikje masive nga Maqedonia, jo vetëm të rinjve por edhe qytetarë të moshave të ndryshme.

Ky ishte qëndrimi i Shtefan Peter, Kryetari të Këshillit të Investitorëve të huaj në Maqedoni. Në konferencën për shtyp të ditës së martë, mbajtur në hapësirat e Odës Ekonomike të Maqedonisë, kryetari Peter potencoi se me mos hyrjen e Maqedonisë në Bashkimin Evropian ekzistojnë mundësi të mëdha të kemi ulje të importit dhe eksportit, kompanitë vendore do të humbin konkurrencën ndërsa të rinjtë, sidomos kuadri profesional dhe intelektualët do të ikën në numër më të madh jashtë Maqedonisë.

“Me votën ‘JO’ për hyrje në BE në referendum Maqedonia mund të humb kredibilitetin, të rinjtë do të humbin besimit në ardhmërinë. Nëse të rinjtë e humbin besimin në ardhmëri atëherë ka të rritet



shpërngulja e tyre nga Maqedonia. Me votën ‘JO’, referendumit vihet në pikëpyetje siguria e denarit si stabiliteti i sektorit bankar në Maqedoni”, tha Peter. Ai nënvizoi se çdo qytetar ka të drejtë të shprehet lirshëm në referendumin e ditës së diel, por Maqedonia në BE do të ishte shumë më stabile se sa jashtë BE-së që njehërit do të thotë qasje më të madhe deri te kreditë e lira si dhe treg stabil për import dhe eksport.

“Çdo qytetar e ka të drejtën absolute të dielën të del dhe të votojë dhe nuk është aq me rëndësi se si

do të votojë. E para është shumë e rëndësishme të dilni në votim dhe në mënyrë aktive të jeni pjesëmarrës në demokraci. Mirëpo mos u bëni vetjak dhe të mendoni vetëm për veten por mendoni për pasojat që mund të sjell vota juaj ‘JO’ për ardhmërinë. Që të funksionojë demokracia është e patjetërsueshme të jeni popull që do të merrë pjesë në votim e jo vetëm të jeni vëzhgues. Ai i cili nuk të votojë, e humbë të drejtën për tu ankuar. Pavarësisht rezultatit përfundimtar, pas 30 shtator jeta në Maqedoni vazhdon por nuk jam i

sigurt se Maqedonia do të mund të mbijetojë duke qenë jashtë Bashkimit Evropian”, deklaroi Peter.

Vota “JO” në referendumin e 30 shtator për Shtefan Peter, kryetarin e Këshillit udhëheqës të investitorëve tu huaj në Maqedoni, do të thotë humbje e 1 miliard eurove të ndihmave financiare nga BE-ja, zvogëlimin e investimeve të huaja direkte si zhvlerësimi i denarit, që do të do të ushtronte presion mbi sektorin bankar si dhe të drejtën e marrjes së kredive më kamata të ulta. “Nëse shumica e qytetarëve të dielën votojnë pro

referendumit atëherë do të ketë kushte më të mira për bërje biznes dhe do të ketë më shumë vende të reja pune. Unë dua nga dita e hënë Maqedoninë ta shoh në BE-dhe NATO”, tha Peter. Sipas tij, është e rëndësishë së veçantë që qytetarët e Maqedonisë ta kenë të qartë se BE-ja është projekti më i suksesshëm në kontinentin evropian në shekullin e 21.

“Suksesi ka të bëjë me paqen, sigurinë, stabilitetin dhe perspektivat. Shtetasit e BE-së jetojnë më gjatë dhe kanë indeks të lartë të zhvillimit njerëzor. Ekonomia në BE është me forta në botë dhe merr pjesë me 23 për qind në vlerën nominale të Bruto Prodhimit Vendor. Mbi gjysma e ndihmave financiare në botë janë nga BE-ja përmes të cilave BE-ja dëshiron të përforcojë vlerat evropiane. BE nuk është e plotë pa Maqedoninë. Të dielën e keni shansin e fundi të jeni në familjen e 28 shteteve evropiane ose do të mbeten shtet i izoluar edhe shumë vite tjera. Unë dhe Këshilli i Investitorëve të Huaj e duam Maqedoni në BE”, tha për fund Shtefan Peter, kryetari i Këshillit të Investitorëve të huaj në Maqedoni.

ANKETË E KOMISIONIT EVROPIAN PËR CILËSINË E JETËS

Qytetarët e Maqedonisë dhe Serbisë renditen menjëherë pas Shqipërisë dhe Turqisë për përqindjen më të lartë të të anketuarve në anketën e Komisionit Evropian për mundësinë e humbjes së vendit të punës në gjashtë muajt e ardhshëm

## Frikë se mund të humbin vendet e punës



Shkup, 25 shtator - Qytetarët e Maqedonisë dhe Serbisë renditen menjëherë pas Shqipërisë dhe Turqisë për përqindjen më të lartë të të frikësuarve se mund ta humbasin vendin e punës në gjashtë muajt e ardhshëm. Përgjigjet e pyetjes: “Sa gjasa ka që të humbin vendin e punës në gjashtë muajt e ardhshëm?”, anketë kjo e realizuar nga Komisioni Evropian, ka treguar se në Shqipëri, 28 për qind kanë frikë se mund të humbasin vendin e punës, në Turqi 23 për qind, e pasuar me 17 për qind në Maqedoni dhe Greqi.

Njohësit e tregut të punës në vend thonë se përqindja kaq e

madhe e të anketuarve në Maqedoni që janë të frikësuar se mund të humbin vendin e punës, mund të shpjegohet me mospranimin e trendeve të reja evropiane dhe botërore të punës tek ne që imponojnë ndërrimin e më shumë vendeve të punës përgjatë një stazhi jetësor pune.

“Tregu i punës në Maqedoni në përgjithësi është relativisht stabil

dhe nuk ka turbulencë më të mëdha, andaj është vështirë të thuhet se prej nga dalin konstatimet që ju theksoni për pasigurinë e madhe për një vend punë tek ne. Ndoshta kjo mund të shpjegohet me shprehinë dhe traditën e punëtorëve në Maqedoni që të pensionohen në ato vende pune ku janë punësuar dhe të mos ndryshojnë asnjë vend pune, për dallim prej

trendeve evropiane të cilat që prej dhjetë vitesh diktojnë që të mos ketë një punësim të përgjithshëm, por të ketë punë të përgjithshme që nënkupton se punëtori që humb një vend pune, menjëherë të gjejë një vend tjetër pune që si koncept - akoma është shumë larg botëkuptimeve tona në Maqedoni”, thotë drejtori i Agjencisë për punësim të përkohshme “Part-

ner”, Rade Nenadiq.

Sipas tij, faktor tjetër që mund të ndikojë në këtë pasiguri mund të jetë edhe niveli i caktuar i kontratave të punës me kohë të caktuar, por që megjithatë si total, është shumë më i vogël se mesatarja evropiane kontratave të punës me kohë të caktuar.

Në ndërkohë, ndër vendet anëtare të Bashkimit Evropian, Gjermania si shtet ku sindikata janë shumë të forta dhe Malta, janë shtetet ku përqindja e të anketuarve të cilat kanë thënë se kanë gjasa që të humbasin vendin e punës është më e ulët, vetëm 5 për qind. Ndërsa ndër vendet anëtare të BE-së që kanë përqindjen më të lartë të njerëzve që kanë frikë se në gjashtë muajt e ardhshëm mund të humbasin vendin e punës, është Greqia me 17 për qind. Më pas renditet Lituania dhe Qipro me 16 për qind, si dhe Estonia dhe Letonia me nga 15 për qind. Përqindjen më të ulët në rajon e ka Mali i Zi, ku vetëm 14 për qind e të anketuarve janë shprehur se ka gjasa se mund ta humbasin vendin e punës. (F.P.)

## STATISTIKAT JAPIN ALARMIN

# KUSH DO T'I MBAJË PENSIONISTËT?

Në dhjetë vitet e ardhshme do të vihen në pikëpyetje qëndrueshmëria e financave publike, fondeve pensionale dhe tërë sistemi i sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore. Kjo për shkak se popullsia që po plakët është duke ushtruar një presion të madh jo vetëm mbi pjesën aktive të popullsisë, por edhe mbi të gjithë ekonominë, e cila po përballë me një kosto të lartë financiare për të siguruar shërbimet sociale për nxënësit, por edhe për të moshuarit



Koha

Evis HALILI

Shkup, 25 shtator - Trendet e ndryshimeve demografike të viteve të fundit do të pasqyrohen negativisht në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit në dekadat e ardhshme. Rritja e shkallës së varësisë së moshës, e cila në Maqedoni është shumë më poshtë sesa mesatarja e BE do të krijojë pas disa vitesh një situatë të atillë ku numri i punëtorëve që do të duhet të "punojnë" për të mbajtur një pensionist do të jetë edhe më i vogël, që nënkupton se barra financiare mbi popullsinë e aftë për punë do të jetë më e madhe. Alarmi jepet nga Enti Shtetëror i Statistikave, sipas të cilit në dhjetë vitet e ardhshme do të vihen në pikëpyetje qëndrueshmëria e financave publike, fondeve pensionale dhe tërë sistemi i sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore. Kjo për shkak se popullsia që po plakët është duke ushtruar një presion të madh jo vetëm mbi pjesën aktive të popullsisë, por edhe mbi të gjithë ekonominë, e cila po përballë me një kosto të lartë financiare për të siguruar shërbimet sociale për nxënësit, por edhe për të moshuarit. Ndryshe shkalla e varësisë arrin në 19.2 për qind, që do të thotë se për një person inaktiv duhet të punojnë pesë të tjerë. "Gjatë periudhës së kaluar vërehet një rritje e vogël por në kontinuitet e shkallës së varësisë së moshës, që tregon për raportin potencial mes numrit të

pensionistëve dhe të popullsisë aktive në punë. Shkalla e plakjes së popullsisë është një element vendimtar që ndikon mbi qëndrueshmërinë afatgjatë, dhe kjo jo vetëm në aspektin biologjik. Shkalla e përshpejtuar e plakjes i redukton kapacitetet e shtetit që të përballë me një sërë problemesh, sidomos kur ky proces ndodh në kushtet e varfërisë, mungesës së resurseve, në zona ekologjikisht të cenueshme dhe në një model jostabil të prodhimit dhe konsumatorit", analizohet ndër të tjera nga ESHS.

Në një prej dokumenteve më të fundit "Zhvillimi i qëndrueshëm" vërehet se ekuilibrat në strukturën e moshës së popullsisë janë prishur duke bërë që plakja e popullsisë të vazhdojë me ritme të përshpejtuara. Jetëgjatësia rritet, por një gjë e tillë nuk ndodh me fertilitetin, si parakusht për qëndrueshmërinë e popullsisë. Fertiliteti është

nën nivelin referues, duke arritur në më pak se dy fëmijë për një grua (1.43) dhe që do të thotë se pas disa vitesh do të sjellë ndryshimin e ekuilibrave mes gjeneratave dhe nevojën për të planifikuar fonde shtesë pensionale, mbrojtje shëndetësore, arsimit dhe përkujdesje për më të moshuarit.

"Këto ndryshime negative në madhësinë dhe në strukturën e moshës së popullsisë përbëjnë një sfidë të madhe për zhvillimin e qëndrueshëm në dekadat që vijnë. Pasi edhe faktorët demografikë, sidomos shkalla e fertilitetit kushtëzohen edhe nga faktorët ekonomikë dhe gjendja e tregut të pumës. Shtimi natyral i popullsisë gjatë viteve 50-të krijojë një popullsi që ose e ka mbyllur ciklin e marrëdhënieve të punës, ose që do të jetë në këtë fazë gjatë 20 viteve të ardhshme", konstatohet nga demografët.

## NË SHKUP JETON MBI 30 PËR QIND E POPULLSISË

Shkupi është një prej zonave ku është përqendruar mbi 30 për qind e popullsisë së përgjithshme, duke bërë që dendësia e popullsisë që në nivel vendi është 83 banorë në kilometër katror, në Shkup katërfish më e lartë dhe arrin 346 banorë në kilometër katror. Kjo për shkak se sipas të dhënave zyrtare zhvendosjet nga zonat urbane dhe rurale kanë pasur kryesisht si destinacion kryeqytetin. Vetëm në vitin 2017 numri i personave të migruar nga fshati dhe qytetit është rritur rreth katër për qind, pjesa më e madhe e të cilëve janë vendosur në Shkup. Një tjetër zonë me dendësi të madhe është Pollogu ku jeton 15.5 për qind e popullsisë së përgjithshme dhe dendësia arrin në 133 banorë në një metër katror, ndërsa rajone të tjera, si Vardari dendësia e popullsisë është dy herë më e vogël sesa ajo mesatare dhe arrin në 37.7 banorë në kilometër katror.

## Ndihmë teknike ndërkombëtare për të dhënat e popullsisë

Shkup, 25 shtator - Gjatë periudhës prej 17 deri më 21 shtator 2018, në Shkup u zhvillua një mision ekspertues për ofrimin e ndihmës teknike për Entin Shtetëror të Statistikës, për promovimin e të dhënave të popullsisë, duke përfshirë regjistrimin, të mbështetur nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë. Misioni u drejtua nga Werner Haug, ekspert ndërkombëtar për popullsi dhe për regjistrimin e popullsisë, drejtori i Entit Shtetëror të Statistikave, Apostol Simovski, zëvendës-drejtori i ESHS-së, Zira Ademi, drejtor i Zyrës së Fondit të Kombeve të Bashkuar për Popullsinë, Doina Bologa dhe ndihmës përfaqësues e Zyrës së FKBP-së në Maqedoni, Sonja Tanevska. Qëllimi i vizitës së ekspertit ndërkombëtar ishte informimi i përfaqësuesve relevantë në vend dhe mbështetja lokale, e



cila parashikon forcimin e kapaciteteve kombëtare për grumbullimin e të dhënave për popullsinë, analizën, shpërndarjen dhe përdorimin e tyre në politikën e zhvillimit. Zyra e Statistikave Shtetërore dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara, nënshkruan një memorandum mirëkuptimi në korrik të këtij vit, i cili përfshin monitorimin e progresit në zbatimin e politikave

dhe strategjive kombëtare në lidhje me përfshirjen sociale dhe shëndetin riprodhues të adoleshentëve, grave dhe burrave në shtet, si dhe angazhime të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare që janë në përputhje me Partneritetin për Zhvillimin e Qëndrueshëm të OKB-së për periudhën 2016-2020, të nënshkruar nga Qeveria dhe ekipi i OKB-së në vend. (Q.A)

## KRONIKË

### Aksident i rëndë rrugës së Kosovës, vdes 19-vjeçari nga Shkupi

Aksident i rëndë automobilistik ka ndodhur sot në ora 3 të mëngjesit, ku një i ri shqiptar nga Shkupi, ka ndërruar në vendngjarje, ndërsa dy bashkudhëtarë tjerë kanë përfunduar të lënduar. Viktima është Dren Kadriu, 19-vjeçar, djali i një këngëtarit dhe kreativeje të njohur të Shkupit. Aksidenti ka ndodhur në rrugën për Kosovë, afër pompës së benzinës "Euroaktiva", ku për shkak të shpejtësisë së madhe, vetura e Drenit është përplasur me rrethojën e një objekti aty afër. Dy bashkudhëtarët tjerë mësohet se janë jashtë rrezikut për jetë.

### Shkup, 15 aksidente për 24 orë

Trembëdhjetë persona janë lënduar më lehtë në tetë nga gjithsej 15 aksidente që kanë ndodhur gjatë 24 orëve në Qytetin e Shkupit. Në shtatë aksidente është shkakuar vetëm dëm material. Gjatë 24 orëve me shpejtësi më të madhe nga e lejuara kanë drejtuar automjetin 35 shoferë, dy kanë qenë nën ndikim të alkoolit, 12 kanë drejtuar automjetin para se të marrin të drejtën të drejtimit të automjetit dhe tre kanë qenë fillestarë. Gjashtë shoferë kanë kaluar udhëkryqin në dritë të kuqe, ndërsa dy nuk u kanë dhënë përparësi këmbësorëve. Nga trafiku janë përjashtuar 13 automjete të paregjistruara dhe një teknikisht të parregullta. Policia e trafikut ka lëshuar 14 gjoba për parkim të parregullt, ndërsa me automjetin special "karrotrec" janë larguar 65 automjete.

### Rrëmbehjet dhe rrahjet një djalë në Haraçinë

Gjashtë persona të armatosur e kanë rrëmbyer dhe rrahur një djalë të moshës 22 vjeçare në Haraçinë për shkak të hesapeve të paqëruara familjare në lidhje me ish të fejuarën e tij nga fshati Haraçinë. Siç kumtoi MPB-ja, dje rreth orës 19:30 nga Kompleksi i Klinikave "Nëna Terezë" në Shkup, ishte denoncuar se ishte sjellë N.R. i cili kishte marrë lëndime nga një sulm fizik në fshatin Haraçinë. Pas masave të ndërmarra, ishte konfirmuar se të njëjtën ditë rreth orës 13 në fshatin Haraçinë në rrugën "1", derisa N.R. e ngiste veturën "Audi", dy vetura i kishin dalë përpara, me çka nga të njëjtat kishin dalë gjashtë persona të armatosur. Gjatë kësaj, me njërin nga veturat, e kishin dërguar të dëmtuarin në një objekt në rrugën "11" në fshatin Haraçinë, ku fizikisht e kishin sulmuar, dhe e kishin mbajtur të mbyllur rreth gjysmë ore. Pastaj, në objekt kishte arritur kushëri i N.R. i cili e kishte dërguar atë në Kompleksin e klinikave "Nëna Terezë" për dhënien e ndihmës mjekësore. I dëmtuari, si autorë për veprën i kishte theksuar disa persona nga fshati Haraçinë, ndërsa policia po ndërmerr masa për zbardhjen e rastit.

**Ngritja e padisë nga sopotasit për realizimin e të drejtë së dëmshpërblimit, në vetë ngërthen edhe implikime financiare. Pala mbrojtëse e të dëmtuarve shprehet se nënçmimi që iu bëhet këtyre personave është tejet diskriminues dhe i padrejtë**

Koha

Omer XHAVERI

Shkup, 25 shtator - Ministria e Drejtësisë nuk ka bazë ligjore për vlerësimin e dëmshpërblimit të shkaktuar nga dhimbja shpirtërore. Këtë qëndrim të martën e përsëriti Ministria e Drejtësisë, Renata Deskoska, e cila theksoi se lënda për të dëmtuarit e rastit të "Sopotit" është trajtuar ashtu si shumë raste tjera deri më tani.

"Të gjithë personat që padrejtësisht kanë vuajtur dënimin me burg apo kanë qëndruar në paraburgim, iu takon dëmshpërblim. Problemi qëndron se Ministria e Drejtësisë nuk disponon me kriteret të qarta se në bazë të cilëve rregullave do të vlerësohet "dhimbja shpirtërore". Megjithatë, Gjykata Civile është organi i cili mund të kryej këtë punë. Bëhet fjalë për procedurë standarde të cilën e kemi zbatuar. Ne javën e kaluar kishim diskutim ku një Komitet i përzier i debatoi për realizimin e

"SOPOTI" NË LABIRINTET E DREJTËSISË

# NË GJYKATËN CIVILE, SI PALË E DËMTUAR



vendimeve të Gjykatës së Strasburgut, me çka u tha se për disa lëndë duhet të paguhet dëmi jomaterial dhe kjo ishte tema që e zhvilluam, respektivisht në çfarë mënyrë të procedohet praktika gjyqësore. Ekzistojnë disa aktivitete që do të ndërmerren Gjykata e Lartë dhe ajo e Apelit për bashkimin e praktikës

gjyqësore, por në atë mbledhje ku marrin pjesë përfaqësues të gjyqësori është arritur në përfundim se një pjesë e lëndëve nuk mund të tarifohet saktësisht, për shkak se disa herë pagesa ndryshon nga rrethanat, siç janë mosha, kushtet e arsye tjera. Për këtë arsye organi më relevant është vetë Gjykata, e

cila duhet të realizojë vlerësimin", tha Deskoska.

Refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim, të dëmtuarit e rastit të "Sopotit" e kanë pranuar me dhimbje dhe zhgënjim të madh. Mosprocedimin e menjëhershëm të procedurës për dëmshpërblim ata e cilësuan si një padrejtësi të

radhës që iu bëhet atyre dhe të afërmeve të tyre. Duke i komentuar deklaratat e të dëmtuarve, ministria Deskoska, tha se në kuadër të dikasterit që ajo e drejton ekziston një praktikë afatgjate të cilën e kanë zbatuar edhe paraardhësit e saj.

"Për këtë lloj të dëmshpërblimit vlera dhe lartësia e saj duhet të miratohet në gjykatë. Unë nuk kam të drejtë sipas vlerësimeve të mija të nënshkruaj marrëveshje. Mjetet që do ti aprovoj gjykata ne si ministri pa asnjë dyshim do ti paguajmë", u shpreh ajo.

Ndryshe, ngritja e padisë nga sopotasit për realizimin e të drejtë së dëmshpërblimit, në vetë ngërthen edhe implikime financiare. Pala mbrojtëse e të dëmtuarve shprehet se nënçmimi që iu bëhet këtyre personave është tejet diskriminues dhe i padrejtë. Ngjashëm si Gjykata Penale e Shkupit, ashtu edhe ajo Civile njihen si institucione ku proceset gjyqësore zgjasin me vite të tëra. Pikërisht kjo ishte njëra ndër arsyt kryesore se pse avokatët dhe të dëmtuarit e "Sopotit" nuk dëshironin që dëmshpërblimi të arrihet përmes rrugës gjyqësore. Tortura psiko-fizike e sopotasve nëpër gjykata për 15 vite me radhë paraqet njërin prej proceseve më të gjata dhe më të padrejta në Maqedoni. Mirëpo, për pushtetin e ri rasti i "Sopotit" i cili ndodhi në vitin 2003, (në kohë kur me qeverinë kryesonte LSDM), nuk ishte indikacion i mjaftueshme që të përmbillet me një marrëveshje të arritur mes të dëmtuarve dhe Ministrisë së Drejtësisë.

## Me OSBE-në bashkë për arsimin



Shkup, 25 shtator - Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi, ka zhvilluar takim me ambasadorin e ri të emëruar të Misionit të OSBE-së në Republikën e Maqedonisë, Shkëlqesinë e Tij, Klemens Koja. Në këtë takim, ministri Ademi e ka uruar ambasadorin Koja në detyrën e re, shefi i Misionit të OSBE-së në Republikën e Maqedonisë, duke i dëshiruar suksese në punë. "Në takim u veçua bashkëpunimi i deritanishëm i suksesshëm ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Misionit të OSBE-së, ku u nënvizua se MASH e vlerëson rolin e OSBE-së dhe përkrahjen që e ofron në procesin e avancimit të bashkëjetesës dhe marrëdhënieve ndëretnike. Në këtë drejtim, ministri Ademi ka shprehur bindjen e tij se Ministria e Arsimit dhe Shkencës edhe në të ardhmen do ta vazhdojë bashkëpunimin me OSBE-në me qëllim të mbështetjes së proceseve reformuese në pjesën e arsimit dhe përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike", thuhet në komunikatën e MASH-it drejtuar mediave.

## VAZHDON GJYKIMI I HULIGANËVE TË PARLAMENTIT

### 27 prilli i orientuar kundër Zaevit, Spasovskit, Shilegovit...

Shkup, 25 shtator - Me dëshminë e Aco Angelovskit, ish-truproja e Oliver Spasovskit, në Gjykatën penale në Shkup vazhdoi gjykimi për ngjarjet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më 27 prill të vitit 2017. Në pyetjen e prokurores Vilma Ruskoska, dëshmitari tha se më 27 prill ka qenë pjesë e ekipit të sigurimit personal të Oliver Spasovskit. Sqaroi se me automjet të njëjtën ditë rreth orës 10 së bashku me Spasovskin kanë arritur në Kuvend dhe ata kanë mbetur në automjet. "Më erdhi çudi dhe pazakonshme që ka aq pak policë rreth Kuvendit. Pyeta për atë njërin prej policëve të hyrja Viner dhe me tha se një numër i madh i policëve po shfrytëzojnë pushimet mjekësore", tha Angelovski. Rreth orës 18 ka marrë thirrje nga koelgu Sasho Tasevski, i cili i ka thënë se kanë urdhër të hyjnë në pres sallën e Kuvendit, pasi u janë kërcënuar jetët Spasovskit dhe të tjerëve. Në Kuvend kanë hyrë nga hyrja kryesore, ku veçmë janë hapur dyert. "Kur hymë në pres qendrën, Spasovski dhe të tjerët ishin në një skaj. Kishte shumë njerët me fantome, ndërsa turma gjuante me çka ka mundur. Shumë turma deputetët u lënduan dhe ne u ndalëm si mburojë e gjallë", tha Angelovski. Ai shtoi se është qëlluar me një shufër nga metali në kokë, për çka ka edhe dokumentacion mjekësor. Sulmet dukeshin si të jenë të komanduara. Mendimi im është se tërë sulmi ishte i orientuar drejt Zoran Zaevit,



Oliver Spasovskit, Petre Shilegovit dhe deputetëve tjerë. Ishim të asfiksuar dhe një orë e gjysmë na maltretonin. Isha në shok dhe dëgjova se dikush jep urdhër, vrisni. Turma veçmë ishte nisur drejt neve dhe unë e nxorra legjitimacionin policor dhe pistoletën. Bërtita polic, zbrapsuni dhe gjuajta një plumb. Atëherë turma duket si u largua pak. Kjo ishte sipas vendimit dhe bindjes sime, pasi 12 vjet kam punuar si sigurim në Kuvend", tha Angelovski. Pas një kohe, tha ai, sulmet sërish vazhduan dhe tani ishin të orientuara ndaj meje. Njëri me fantom mu afrua dhe me goditi tre-katër grushta, me ç'rast u përgjaka në gojë", tha ai. Pas një kohe u dëgjua edhe një shpërthim i fuqishëm dhe hyri Njësia

për reagim të shpejtë, bëri korridor dhe na dërgoi në zyrën e Gjorçevit. Angelovski gjatë marrjes në pyetje ishte mjaftë i shqetësuar dhe në disa momente fliste me lotë në sy. Në pyetje të mbrojtjes nëse i duhet urdhër që të gjuajë ose të mbrojë dikë, dëshmitari sqaroi se nëse jeta është në rrezik, ata nuk mund të presin urdhër që të vepronë, por vepron sipas detyrës zyrtare. Për ngjarjet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë më 27 prill të vitit 2017 janë akuzuar 33 persona, prej të cilëve 31 person për kanosje terroriste të rendit kushtetues të shtetit dhe dy për nxitje. Mes të akuzuarve janë disa deputetë, të punësuar në MPB dhe sigurimin e Kuvendit, artistë dhe qytetarë.

Statistikat tregojnë se Gjermania regjistron gjithnjë e më shumë punëtorë të huaj. Vetëm në tetë muajt e parë të vitit të kaluar, Agjencia Federale e Punës ka lëshuar leje pune për 63.000 persona vetëm nga Ballkani Perëndimor. Ekziston kërkesa e madhe në ndërtimtari, hoteleri, shërbime mjekësore, pastrues, kujdestar për personat e vjetër, kopshtar etj

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 25 shtator - Një numër i madh i qytetarëve të Maqedonisë largohen nga vendi për të siguruar të ardhmen e tyre në ndonjë shtet evropian. Gjermania tradicionalisht është shteti më atraktiv për mërgimtarët nga Maqedonia dhe rajoni, si për shkak të traditës së mërgimit në këtë shtet, lidhjeve familjare dhe shoqërore që lehtësojnë adaptimin në rrethin e ri të punës dhe jetesës, por edhe tregut të punës të uritur për profilet e ndryshme të punëtorëve nga jashtë. Ndër profesionet më të kërkuara në vitet e fundit, krahas punëtorët në ndërtimtari, infermierëve, mjekëve apo programuesve, janë edhe berberët. Pagat e berberëve nga rajoni në Gjermani, me një njohje minimale të gjuhës gjermane është prej

## SHPËRNGULJA E FUQISË PUNËTORE

EDHE BERBERËT  
IKIN NË KURBET

1200 deri 1600 euro.

Një pjesë e berberëve më të vjetër në Shkup në kushte anonimiteti thonë për gazetën KOHA, se në Gjermani dhe Zvicër ikin në kurbet berberët e moshës prej 18 deri 30 vjeç, kryesisht të pamartuar, ndërsa ata që kanë familje më rrallë vendosin të ikin jashtë.

“Mundësia që duke punuar në mërgim që për tre deri katër vjet të blejnë një banesë në vendlindje, në vend se të presin duke punuar këtu që së paku dhjetë vite të fitojnë kullmin nën kokë, paraqet arsye kryesore pse berberët e rinj na ikin jashtë. Të mos harrojmë se një qethje tek ne kushton diku 2.5 euro në raport me dhjetë euro në shtetet

perëndimore, andaj edhe berberët të joshur nga ky çmim atraktiv ikin jashtë”, shpjegojnë berberët veteran shkaqet e ikjes së madhe të kolegëve të tyre të rinj jashtë vendit.

Ata shtojnë se edhe ambienti i tensionuar politik në shtet në vitet e kaluara, si dhe mungesa e një perspektive më të qartë shtyn të rinjtë drejt rrugës së mërgimit.

Në ndërkohë, analizat e ndryshme tregojnë se Gjermania në të ardhmen do të tregojë vartësi të madhe prej fuqisë punëtoare nga shtetet e treta që aktualisht nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian. Njohësit e tregut gjerman të punës presin që gradualisht të ndryshohet kërkesa për punëtorë

prej asaj nga shtetet anëtare të BE-së që edhe më lehtë punësohen brenda unionit, në kërkesën më të madhe për punëtorë nga jashtë BE-së. Në këtë drejtim, janë ndër-marrë edhe më shumë veprime që atyre t’ju lehtësohet marrja e lejes së punës dhe lejes së qëndrimit në bazë të kualifikimeve të tyre profesionale si për mjeshtër të profileve të ndryshme, ashtu edhe për profesionet me arsim të lartë.

Statistikat të më the tregojnë se Gjermania regjistron gjithnjë e më shumë punëtorë të huaj nga Ballkani Perëndimor. Vetëm në tetë muajt e parë të vitit të kaluar, Agjencia Federale e Punës ka lëshuar leje pune për 63.000 persona

nga Ballkani, tregojnë shifrat e bëra publike nga vetë ky institucion. Falë skemës së lehtësuar rreth 70 për qind më shumë punëtorë të huaj janë regjistruar në Gjermani në 8 muajt e parë të vitit 2017. Shumica e vizave janë lëshuar për persona që punojnë në industrinë e ndërtimit, ndërkohë që akademikët përbëjnë një përqindje të vogël. Me fjalë të tjera, më shumë leje pune në Gjermani ju ndahen kandidatëve që kërkojnë punë në ndërtimtari, ndërsa për fuqinë punëtoare nga Ballkani ekziston kërkesa e madhe edhe në sektorin e hotelierisë, pastrues, kujdestar apo përkujdesës për personat e vjetër dhe kopshtar.

## VITI I RI SHKOLLOR ME PROBLEME TË VJETRA

Një shumë totale prej 53,000 euro është paguar nga ana e prindërve për kompensim të librave të dëmtuar gjatë vitit 2017, mirëpo kundrejt kësaj nxënësit mbasin përsëri pa tekste shkollore. Për prindërit rëndësi më të madhe ka kualiteti kundrejt kuantitetit, ndërsa drejtori i shkollës “Penko” në Shkup theksoi se së shpejti pritet furnizimi i të gjithë nxënësve

## PRINDËRIT PAGUAJNË, FËMIJËT MBESIN PA LIBRA



mesme, gjithsej 14.500 paralele, i bie që mesatarisht një klasë ka bërë dëme prej 3.65 euro për një tekst shkollor. Nga kjo mund të konkludohet se bëhet fjalë për një shumë të vogël në krahasim me çmimin miliona euro që MASH çdo vit ua paguan shtëpive botuese për të prodhuar dhe ofruar libra të rinj për shkollat.

Nga MASH thonë se lista e çmimeve për vitin aktual shkollor për pagesën e një libër të dëmtuar ose të humbur veçmas, bëhet në muajin prill dhe pagesa është 70% e vlerës së tregut.

“Departamenti adekuat për-

gatit listën e çmimeve për kompensimin e teksteve të dëmtuara në muajin prill ose maj për çdo vit veç e veç. Kjo është për shkak se në atë kohë të vitit përcaktohet nëse një tekst është dëmtuar apo jo, tashmë është herët për të. Nëse shtëpitë botuese tashmë kanë një tekst të rregullt, secili individ mund të blejë një të tillë të ri dhe ta zëvendësojë atë me një të vjetër – thonë nga MASH.

Sipas listës së çmimeve të vjetra të botuar për 2017/2018, pagesa për tekste të dëmtuara në arsimin fillor, në varësi të lëndëve, lëviz nga 40 në 100 denarë, në

shkollat profesionale nga 100 në 200 denarë dhe në gjimnaze prej 200 deri në 400 denarë. Sipas rregullores, pas përfundimit të vitit shkollor, nxënësit deri në fund të muajit qershor të vitit aktual shkollor duhet ta kthejnë kompletin e teksteve shkollore të pa dëmtuara tek kujdestari i klasës. Kujdestari i klasës duhet të japë të dhëna rreth prindërve të cilët i kanë kthyer tekste shkollore, me të dhëna si, (titulli i teksteve shkollore, autori), gjendja në të cilën janë kthyer librat (të përdorshme apo të dëmtuara). Të dhënat evidentohen mënyrë elektronike për tekste që janë kthyer, se cilat mund të përdoren për vitet e ardhshme shkollore dhe për tekste që janë të dëmtuara dhe cilat nuk mund të përdoren. Për tekste të dëmtuar, lëshohet fletëpagesë, e cila paraqitet dëshmi nga prindërit se transaksioni është kryer dhe kanë paguar dëmshpërblimin.

Mirëpo jo të gjithë nxënësit edhe këtë vit shkollor hasën në mungesë të librave, përkundrejt asaj që MASH kishte premtuar furnizimin e plotë të nxënësve me libra. Për Gazetën Koha drejtori i

Shkollës Fillore-Petar Zdarvovski-Penko, Enis Mehmeti deklaroi se shumica e nxënësve janë furnizuar me libra dhe beson se deri në fund të javës të gjithë nxënësit do të furnizohen me libra.

“Në përgjithësi është në rregull dhe deri në fund të javës presim furnizimin e të gjithë nxënësve me libra, këtë vit është më mirë se vitet tjera. Por duhet që edhe nxënësit të bëjnë kujdes ndaj librave dhe ti ruajnë ato”, tha Mehmeti.

Për prindërit rëndësi më të madhe luan edhe cilësia e librit sepse nga aty fëmijët e tyre i marrin njohuritë. “Rëndësi të madhe përveç sasisë që është problematike, duhet ti kushtohet edhe cilësisë dhe përmbajtjes. Për mua rëndësi më të madhe ka cilësia sepse sasia zëvendësohet por cilësia jo. Është e pa tolerueshme duke pasur partinë tonë në pushtet ti tolerojmë skandalet e tilla”, tha Luran Ahmeti, në cilësinë e prindit. Nga MASH thanë se këtë vit, gjatë negociatave me shtëpitë botuese, është arritur një çmim blerje, që është 40% më i ulët krahasuar me vitet e kaluara.

Koha

Remzije BILALI

Shkup, 25 shtator - Prindërit kanë paguar rreth 53,000 euro për kompensimin e teksteve të dëmtuara shkollore gjatë vitit 2017, tregon llogaria përfundimtare e vitit të kaluar e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), nënshkruar nga ish ministrja e MASH, Renata Deskoska.

Në qoftë se në Maqedoni ka 11.000 paralele në shkollat fillore dhe 3.500 paralele në shkollat e



## FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË

## SH P A L L J E

PASQYRË E Pjesëve në pronë të Fondit që do të ofrohen për shitje në Bursën e Maqedonisë përmes Ankandin Publik Bursar në tre ditë rresht të tregëtimit, duke filluar nga 12.10.2018

Nr. rendor	Emri i shoqërisë	Vendi	Pjesa kryesore e shoqërisë në valutë	Pjesë për shitje në valutë	Pjesëmarrja e një pjesë në pjesën kryesore të shoqërisë në %	Çmimi fillestar shitës i një pjesë në denarë (MKD)	Nr. rendor	Emri i shoqërisë	Vendi	Pjesa kryesore e shoqërisë në valutë	Pjesë për shitje në valutë	Pjesëmarrja e një pjesë në pjesën kryesore të shoqërisë në %	Çmimi fillestar shitës i një pjesë në denarë (MKD)
1	BIK SHPK	Bogdanci	2,542,887 MKD	381,375 MKD	15.00%	95,344 MKD	18	AGRO MEKANIKA SHPK	Strumicë	124,784 EUR	18,719 EUR	15.00%	287,828 MKD
2	STACIONI I VETERINARISË KAVADAR SHPK	Kavadar	3,092,400 MKD	215,890 MKD	6.98%	53,973 MKD	19	AGROKOMBINAT MAKEDONIJA SHPK	Shkup	69,972,400 MKD	5,203,300 MKD	7.44%	1,300,825 MKD
3	DRIMKOL PROMET SHPK	Vevčan	6,024,700 MKD	189,800 MKD	3.15%	47,450 MKD	20	ELEKTROKUMANOVO SHPK	Kumanovë	5,290,600 MKD	793,600 MKD	15.00%	198,400 MKD
4	DELTAPROM SHPK	Shkup	190,100 MKD	28,500 MKD	14.99%	7,125 MKD	21	IMEKS SHPK	Prilep	342,249 EUR	26,060 EUR	7.61%	400,705 MKD
5	EVROKAP SHPK	Shtip	63,384 EUR	9,507 EUR	15.00%	146,182 MKD	22	JUGOELEKTRO KOMERC SHPK	Shkup	15,655,180 MKD	1,150,058 MKD	7.35%	287,515 MKD
6	EKSPIM SHPK	Kumanovë	915,500 MKD	256,600 MKD	28.03%	64,150 MKD	23	LOGIKOMPAKT SHPK	Koçanë	2,107,245 MKD	725,778 MKD	34.44%	181,445 MKD
7	METEKS SHPK	Shkup	12,727,800 MKD	1,909,000 MKD	15.00%	477,250 MKD	24	DRIMKOL OGP SHPK	Prilep	8,910,000 MKD	105,090 MKD	1.18%	26,273 MKD
8	MARKET-PROMET SHPK	Shkup	1,746,000 MKD	261,900 MKD	15.00%	65,475 MKD	25	MLADOST SHPK	Demir Hisar	191,223 EUR	28,683 EUR	15.00%	441,037 MKD
9	MAKEDONIJPATENT SHPK	Shkup	231,300 MKD	8,900 MKD	3.85%	2,225 MKD	26	NEMETALI SHPK Çeshinovo	Çeshinovo	14,102,170 MKD	2,115,316 MKD	15.00%	528,829 MKD
10	STAKLODIJAMANT SHPK	Shkup	2,051,500 MKD	306,000 MKD	14.92%	76,500 MKD	27	POLIN 98 SHPK	Strumicë	4,980,080 MKD	742,320 MKD	14.91%	185,580 MKD
11	STAVROSKI-1 SHPK	Tetovë	10,705,900 MKD	1,175,100 MKD	10.98%	293,775 MKD	28	SKOPJE-LIPTERM SHPK RZH	Shkup	7,906,100 MKD	705,000 MKD	8.92%	176,250 MKD
12	SERVIS - HARTIJA SHPK	Shkup	14,308,600 MKD	2,146,300 MKD	15.00%	536,575 MKD	29	START MARIJA ETJ. SHPK	Shkup	8,252,400 MKD	827,400 MKD	10.03%	206,850 MKD
13	SOLIDARNOST SHPK	Shkup	28,262 EUR	3,000 EUR	10.61%	46,129 MKD	30	TIKVESH SHPK	Shkup	39,329,203 MKD	2,869,135 MKD	7.30%	717,284 MKD
14	TEMEL UNION 96 SHPK	Negotinë	612,306 MKD	92,451 MKD	15.10%	23,113 MKD	31	HOUMTEKS SHPK	Shkup	5,703,200 MKD	1,414,600 MKD	24.80%	353,650 MKD
15	TUTUNSKO POLE SHPK	Prilep	4,331 EUR	649.60 EUR	15.00%	9,989 MKD	32	ZHITO LEB SHPK	Bogdanci	10,848,200 MKD	1,627,500 MKD	15.00%	406,875 MKD
16	UNIVERZAL SHPK	Shkup	2,022,000 MKD	272,821 MKD	13.49%	68,205 MKD	33	REISKA SHPK	Shën Nikollë	10,411,164 MKD	1,459,640 MKD	14.02%	364,910 MKD
17	STACIONI I VETERINARIS UNIVET SHPK	Radovish	3,649,100 MKD	414,170 MKD	11.35%	103,543 MKD							

Pjesët do të ofrohen për shitje përmes Bursës së Maqedonisë në tre ditë rresht të tregëtimit duke filluar nga 12.10.2018. Pjesa do të bëhet në para të gatshme dhe në denarë.

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË

www.piom.com.mk



Komuna e Kumanovës  
Vetëqeverisja lokale

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18), Kryetari i Komunës së Kumanovës në vijim sjellë

**LAJMËRIM**

Informohen të gjitha subjektet fizike dhe juridike në territorin e Komunës së Kumanovës se publikohet

**Thirrje publike për parashtrim të iniciativave për përpilim të Planeve urbanistike**

Thirrja publike publikohet në pajtim me nenin 21 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18), në kuartalin e tretë të vitit 2018.

- **Thirrja publike do të zgjasë prej 26.09.2018 deri më 27.10.2018 – 32 ditë** duke llogaritur me ditën e publikimit.
- **Thirrja publike do të shpallet** në lajmëtarin zyrtar të komunës, në ueb faqen e komunës [www.kumanovo.gov.mk](http://www.kumanovo.gov.mk), në tabelën për shpallje të komunës, në sistemin informativ e-urbanizam, në gazetë ditore në gjuhën maqedonase dhe në gazetë ditore në gjuhën shqipe.
- **Gjatë kohëzgjatjes së Thirrjes publike** të gjithë subjektet e interesuara fizike dhe juridike mund të dorëzojnë iniciativë për përpilim dhe sjellje të planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika (2) alineja 2, 3 dhe 4 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18).
- **Lënda e iniciativës** mund të jetë sjellja e planit të ri urbanistik ose ndryshim dhe plotësim i planit ekzistues urbanistik **me arsytim për ndryshimin e kërkuar** dhe propozim të përfshirjes planore nga parashtruesi i iniciativës.
- **Subjektet e interesuara juridike dhe fizike** iniciativat ti dorëzojnë në pajtim me nenin 21 paragrafi (3) të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18).
- **Mjetet për iniciativat e pranuar** për përpilim të dokumentacionit të nevojshëm duhet të sigurohen nga vet parashtruesit e iniciativave.

Nr. 21-61018/1  
Data 24.09.2018

Kryetari i Komunës  
së Kumanovës  
Maksim Dimitrievski



NJË KËRKESË E KAMOTSHME QË NUK PËRFILLET

# TETOVA S'KA INTERESIM PËR SHTËPI TË PLEQVE

Në dy thirrjet e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale nuk ka arritur asnjë projekt për ndërtimin e një shtëpie për më të moshuarit në Tetovë



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 25 qershor - Si një komunë qendrore ku gravitojnë mbi 200 mijë banorë, Tetova për dekada të tëra ende nuk ka kujdes institucional për të moshuarit. Gjithashtu, nuk ka zgjidhje për qytetarët e moshuar që kanë një problem banimi të pazgjidhur ose ata që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm shëndetësor. Në dy thirrjet e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale nuk ka arritur asnjë projekt për ndërtimin e një shtëpie për më të moshuarit në Tetovë. Shoqata e pensionistëve nga Tetova për vite të tëra ka kërkuar një shtëpi moderne për të moshuarit, e cila do të plotësojë nevojat e kësaj kategorie të qytetarëve.

"Ato komuna që kanë projekte të gatshme duhej që ato projekte t'i dorëzojë në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe për të njëjtat projekte së bashku do të gjejmë mjete financiare, një pjesë me mjete financiare ndërkombëtare për shkak se miqtë e Maqedonisë qëndrojnë pranë nesh dhe gjithashtu mjete buxhetore për shtëpi të pleqve në Komunën e Tetovës. Unë deri më tani nuk kam pranuar ndonjë projekt", ka deklaruar gjatë vizitës në Tetovës, ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Mila Carovska.

Përndryshe, kjo kategori e qytetarëve të moshuar janë lënë në më-

shirën e më të afërmeve dhe të miqve të tyre, veçanërisht ata që nuk kanë zgjidhur çështjen e strehimit ose nuk kanë të ardhura të përhershme mujore. Disa mbeten vetëm nëse nuk kanë familjar ose farefis të afërt që do të përkujdeset për ato. Në gjendje më të rëndë dhe të palakmueshme janë të moshuarit që nuk janë në gjendje të mirë shëndetësore dhe që kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të vazhdueshme mjekësore. Këta njerëz shpesh dërgohen në shtëpi apo qendra në qytete të tjera të vendit. Objekti në të cilin aktualisht gjendet Shoqata e Pensionistëve të Tetovës përdoret ekskluzivisht për strehimin e

të moshuarve, por është i kufizuar në kapacitete dhe në kushte. Shtëpia e re për të moshuarit, përveç shtëpisë, duhet gjithashtu të sigurojë kujdesin shëndetësor ose kujdesin shëndetësor për përfituesit. Kësisoj, përderisa Shkupi, Manastiri, Shtipi dhe qytete të tjera kanë shtëpi të pleqve, megjithatë pleqtë e Tetovës nuk e kanë një vend të tillë. Ata kohën më të madhe të pleqërisë e kalojnë në karriget e parqeve të qytetit dhe në zyrat e pensionistëve, ku nuk ka hapësira të mjaftueshme.

Nga kjo shoqatë kanë thënë se kërkesa është dërguar në Komunën e Tetovës dhe në Qendrën për zhvil-

lim të rajonit planor, por deri më tash nuk ka ndonjë hap konkret. Shoqata e Pensionistëve të Tetovës nga ana e saj kërkon nga shteti ndërtimin e një shtëpie për personat e moshuar, e cila sipas tyre, është e domosdoshme për këtë kategori të qytetarëve sepse vend tjetër nuk kanë. Nga Komuna e Tetovës theksuan kohë më parë se shtëpitë e pleqve në komunat tjera u janë dhënë në menaxhim komunaive, kurse në Tetovë nuk është bërë një transfer i këtyre.

"Shtëpitë e pleqve si pronë publike me procesin e decentralizimit janë bartur në pronësi dhe menaxhim të pushtetit lokal, në disa komuna si Manastiri, Shkupi. Këto institucione për perkujdesjen e të moshuarve i kanë trashëguar nga pushteti qendror, gjë që nuk është rast edhe me Komunën e Tetovës. Në planet afatshkurta të Komunës së Tetovës është rregullimi dhe mirëmbajtja e klubeve të pensionistëve, kurse ndërtimi dhe mirëmbajtja e shtëpisë së pleqve është projekt kapital, i cili kërkon resurse më të mëdha financiare", ishin shprehur kohë më parë nga Komuna e Tetovës.

Publicitet

Në bazë të nenit 22 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009 130/2009 120/2011, 10/2012, 11/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015 dhe 27/2016), IPKÇF "8 April" – Komuna Shuto Orizarë Shkup publikon

## SHPALLJE

### Për punësim për kohë të pacaktuar të

#### 1 realizues në vendin e punës – pedagog,

Pedagog i diplomuar të arritura 240 kredi sipas SETK, ose arsim të mbaruar sipëror shkalla VII/1 dhe licencë valide për bashkëpunëtor profesional, me dhe pa përvojë pune.

#### 4 realizues në vendin e punës – Përkëdhelës,

Me arsim të mesëm katërvjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës, me përvojë pune. Së bashku me fletëparaqitjen është e nevojshme të parashtrihen:

- Dëshmi për arsimin e mbaruar përkatës (dëftesë, diplomë, certifikatë);
- Certifikatë të shtetësisë;
- Certifikatë të mjekut;
- Certifikatë për njohje të gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm me çka është i dënuar për vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë ose keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefnisor, për vepër penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është caktuar sjellje diskriminuese;

- Afati për parashtrimin e dokumenteve është 10 ditë pune, duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve të punës pas kalimit të afatit për paraqitje.

Orari i punës së:

- Orari i punës për pedagogun është 40 orë ë javë (prej ditës së hënë deri ditën e premte), ndërsa
- Orari ditor i punës është 8 orë në ditë dhe i njëjti është me shkallëzim në periudhë prej ora 07,00 – 16,00;
- Orari i punës së përkëdhelësit është 40 orë në javë (prej ditës së hënë deri ditën e premte), ndërsa
- Orari ditor i punës është 8 orë në ditë dhe i njëjti është me shkallëzim në periudhë prej ora 06,00 – 18,00.

Neto pagesa fillestare për vendin e punës:

Pedagogun është 19.581,00 denarë, ndërsa për përkëdhelësin është 14.780,00 denarë.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i kompletuar dhe i pa rregulluar nuk do të shqyrtohet.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrihet deri në:

IPKÇF "8 April" – Komuna Shuto Orizarë rr. Washingtonska nr. 44 – Shkup



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

### SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 119A/2018

për punësimin e 1 nëpunës shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale “për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B02000 Udhëheqës i sektorit për mbikëqyrjen inspektuese mbi zbatimin e rregullave ligjore dhe të tjera nga sfera e mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve - Inspektor kryesor 1 realizues(ë)

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1
- më së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 2 (dy) vjet udhëheqës në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 8 (tetë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 3 (tre) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat
- të ketë 5 vjet përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale

#### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

#### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- të posedon licencë për inspektor nga sfera e mbrojtjes sociale

#### Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përkrahimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30
- Rroga neto: 35.000,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – të: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – të. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Më 30 shtator ti vendos  
për ardhmërinë tënde!

**DIL PËR  
MAQEDONINË EVROPIANE!**



[www.izleziza.mk](http://www.izleziza.mk)

Në bazë të nenit 22, paragrafi (1), alineja 1 e Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015 dhe 27/2016), dhe në bazë të nenit 22 paragrafi 8 i Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) Agjencia për nxitje të zhvillimit të bujqësisë publikon

## SHPALLJE PUBLIKE

### Për punësim të 9 (nëntë) personave në Agjencinë për nxitje të zhvillimit të bujqësisë për kohë të caktuar

Agjencia për nxitje të zhvillimit të bujqësisë ka nevojë për punësim të 9 (nëntë) personave për kohë të caktuar deri më 31.12.2018 për vendet e punës në vijim:

- Bashkëpunëtor i ri për bujqësi dhe zhvillim rural – prodhimtari bimore në Departamentin për Rajonin Manastir pranë Sektorit për bujqësi dhe zhvillim rural me lokacion të vendit të punës në Strugë, 1 realizues.**

#### Kushtet e përgjithshme:

-të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;  
-në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase  
-të jetë i moshës së rritur;  
-të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe  
-me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, prodhimtaria bimore, teknologjia e prodhimeve ushqimore, teknologjia ushqimore, njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

- me ose pa përvojë pune në profesion.  
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane)

#### Orari i kohës së punës:

Orët e punës në javë: 40,  
Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 07. 30 - 08. 30 deri më 15.30 - 16. 30.

Shuma neto në të holla e pagesës fillestare: 20. 969, 00 denarë

- Bashkëpunëtor i ri për bujqësi dhe zhvillim rural – prodhimtari bimore në Departamentin për Rajonin Tetovë pranë Sektorit për bujqësi dhe zhvillim rural me lokacion të vendit të punës në Tetovë, 1 realizues.**

#### Kushtet e përgjithshme:

-të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;  
-në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase  
-të jetë i moshës së rritur;  
-të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe  
-me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

-niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, pemëtaria, teknologjia e prodhimeve ushqimore, teknologjia ushqimore, njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

- me ose pa përvojë pune në profesion.  
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane)

#### Orari i kohës së punës:

Orët e punës në javë: 40,  
Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 07. 30 - 08. 30 deri më 15.30 - 16. 30.

Shuma neto në të holla e pagesës fillestare: 20. 969, 00 denarë

- Bashkëpunëtor i ri për bujqësi dhe zhvillim rural – prodhimtari bimore në Departamentin për Rajonin Tetovë pranë Sektorit për bujqësi dhe zhvillim rural me lokacion të vendit të punës në Dibër, 1 realizues.**

#### Kushtet e përgjithshme:

-të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;  
-në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase  
-të jetë i moshës së rritur;  
-të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe  
-me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

-niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, prodhimtaria bimore, teknologjia e prodhimeve ushqimore, teknologjia ushqimore, njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

- me ose pa përvojë pune në profesion.  
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane)

#### Orari i kohës së punës:

Orët e punës në javë: 40,  
Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 07. 30 - 08. 30 deri më 15.30 - 16. 30.

Shuma neto në të holla e pagesës fillestare: 20. 969, 00 denarë

- Bashkëpunëtor i ri për bujqësi dhe zhvillim rural – prodhimtari bimore në Departamentin për Rajonin Tetovë pranë Sektorit për bujqësi dhe zhvillim rural me lokacion të vendit të punës në Gostivar, 1 realizues.**

#### Kushtet e përgjithshme:

-të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;  
-në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase  
-të jetë i moshës së rritur;  
-të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe

-me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

-niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, pemëtaria, teknologjia e prodhimeve ushqimore, teknologjia ushqimore, njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

- me ose pa përvojë pune në profesion.  
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane)

#### Orari i kohës së punës:

Orët e punës në javë: 40,  
Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 07. 30 - 08. 30 deri më 15.30 - 16. 30.

Shuma neto në të holla e pagesës fillestare: 20. 969, 00 denarë

- Bashkëpunëtor i ri për bujqësi dhe zhvillim rural – blegtori në Departamentin për Rajonin Tetovë pranë Sektorit për bujqësi dhe zhvillim rural me lokacion të vendit të punës në Kërçovë, 1 realizues.**

#### Kushtet e përgjithshme:

-të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;  
-në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase  
-të jetë i moshës së rritur;  
-të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe  
-me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

-niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, prodhimtaria e blegtorisë (blegtoaria), teknologjia e prodhimeve ushqimore, shkencat ekonomike, njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

- me ose pa përvojë pune në profesion.  
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane)

#### Orari i kohës së punës:

Orët e punës në javë: 40,  
Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 07. 30 - 08. 30 deri më 15.30 - 16. 30.

Shuma neto në të holla e pagesës fillestare: 20. 969, 00 denarë

- Bashkëpunëtor i ri për bujqësi dhe zhvillim rural – blegtori në Departamentin për Rajonin Shkup pranë Sektorit për bujqësi dhe zhvillim rural me lokacion të vendit të punës në Shkup, 1 realizues.**

#### Kushtet e përgjithshme:

-të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;  
-në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase  
-të jetë i moshës së rritur;  
-të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe  
-me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, teknologjia e prodhimeve ushqimore, shkencat ekonomike, teknologjia ushqimore, njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

- me ose pa përvojë pune në profesion.  
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane)

#### Orari i kohës së punës:

Orët e punës në javë: 40,  
Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 07. 30 - 08. 30 deri më 15.30 - 16. 30.

Shuma neto në të holla e pagesës fillestare: 20. 969, 00 denarë

- Bashkëpunëtor i ri për bujqësi dhe zhvillim rural – blegtori në Departamentin për Rajonin Kumanovë pranë Sektorit për bujqësi dhe zhvillim rural me lokacion të vendit të punës në Kumanovë, 1 realizues.**

#### Kushtet e përgjithshme:

-të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;  
-në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase  
-të jetë i moshës së rritur;  
-të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe  
-me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

-niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, prodhimtaria e blegtorisë (blegtoaria), teknologjia e prodhimeve ushqimore, teknologjia ushqimore, njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

- me ose pa përvojë pune në profesion.  
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane)

#### Orari i kohës së punës:

Orët e punës në javë: 40,

Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 07. 30 - 08. 30 deri më 15.30 - 16. 30.

Shuma neto në të holla e pagesës fillestare: 20. 969, 00 denarë

- Bashkëpunëtor i ri për bujqësi dhe zhvillim rural – prodhimtari bimore në Departamentin për Rajonin Kumanovë pranë Sektorit për bujqësi dhe zhvillim rural me lokacion të vendit të punës në Kumanovë, 1 realizues.**

#### Kushtet e përgjithshme:

-të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;  
-në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase  
-të jetë i moshës së rritur;  
-të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe  
-me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

-niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, pemëtaria, teknologjia e prodhimeve ushqimore, shkencat ekonomike, njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

- me ose pa përvojë pune në profesion.  
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane)

#### Orari i kohës së punës:

Orët e punës në javë: 40,  
Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 07. 30 - 08. 30 deri më 15.30 - 16. 30.

Shuma neto në të holla e pagesës fillestare: 20. 969, 00 denarë

- Bashkëpunëtor i ri për përpunim dhe evidencë të dokumentacionit në Departamentin për Punë të përgjithshme dhe aktivitete organizuese pranë Sektorit për Çështje juridike dhe të përgjithshme me lokacion të vendit të punës në Manastir, 1 realizues.**

#### Kushtet e përgjithshme:

-të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;  
-në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase  
-të jetë i moshës së rritur;  
-të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe  
-me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

-niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar, shkencat juridike, shkencat ekonomike, teknika kompjuterike dhe informatikë, njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

- me ose pa përvojë pune në profesion.  
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane)

#### Orari i kohës së punës:

Orët e punës në javë: 40,  
Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 07. 30 - 08. 30 deri më 15.30 - 16. 30.

Shuma neto në të holla e pagesës fillestare: 20. 969, 00 denarë

#### Kandidatët për të gjitha pozitat e punës, duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:

Dëshmi për shtetësi;  
Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;  
Dëshmi për gjendjen e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;  
Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit;  
Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë;  
Dëshmi për njohje të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane);  
Dëshmi për përvojën e punës;  
Biografi të shkurtë (me kontakt telefon të domosdoshëm dhe adresë);  
Letër motivimi.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 3 ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes. Kushtet e theksuara në shpallje kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes. Fletëparaqitja me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrohet deri në arkivin e Agjencisë për nxitje të zhvillimit të bujqësisë ose përmes postës në adresën në vijim:

**Agjencia për nxitje të zhvillimit të bujqësisë  
rr. Kliment Ohridski pn, Pellagonka II 5/3, 7000 Manastir  
(me shenjë "shpallje për punësim")  
Kontakt telefoni 072 252 433**

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Agjencia për nxitje të zhvillimit të bujqësisë

# BE po mbërrin në pikën e vet të shpërbërjes



Nga  
Bill WIRTZ

Në një vendim të papritur të mërkurën e shkuar, Parlamenti Europian vendosi të nxisë një procedurë, për të ndëshkuar një nga shtetet e saj anëtare: Hungarinë. Beteja për të ardhmen e Europës është e hapur. Kur kanë mbetur vetëm 9 muaj deri në zgjedhjet e Parlamentit Europian, disa përçarje po shfaqen në peizazhin politik të kontinentit. Një gjë është e qartë: çështja e emigracionit, do të jetë në ballë të debateve të ardhshme. Kjo temë do të ndajë progresistët, të cilët dëshirojnë centralizimin e mëtejshëm të Bashkimit Europian, nga populistët, të cilët kundërshtojnë delegimin e më shumë kompetencave tek Brukseli.

Vitin e shkuar, presidenti francez Emanuel Makron identifikoi 2 vende si pengesa për integrimin e mëtejshëm europian: Poloninë dhe Hungarinë. Që atëherë, që të dyja vetëm sa janë bërë më të zëshme në kundërshtimin e tyre ndaj burokracisë së Brukselit. Duhet thënë se shumica konservatore në ato vende të Europës Qendrore, e kanë kundërshtuar BE-në në rrafshin e kulturës, trashëgimisë dhe traditës, shumë më tepër sesa të euros, programeve të mëdha të shpenzimeve qeveritare, dhe harmonizimit të sistemit fiskal. Në fakt, Hungaria dhe Polonia ushqejnë shtetet e zgjeruara të mirëqenies sociale, me pak shqetësime për qëndrueshmërinë e shpenzimeve të tyre, kështu që baza e tyre e përbashkët me konservatorët amerikanë, ekziston kryesisht mbi vlerat shoqërore.

Retorika agresive e Makron ndaj Polonisë dhe Hungarisë, përkeqësoi marrëdhëniet e tyre me elitën drejtuese të Europës, edhe para se ai të merrte detyrën. Dhe i tiji është nga çdo lloj matje, zëri më i fortë i BE-së. Makron ka sugjeruar plane për reformimin e unionit, që do të rrisin buxhetin dhe aftësitë e Brukselit, dhe do të thellojnë përçarjen ndërmjet atyre që besojnë tek centralizimi, përkundrajt atyre që mbrojnë të drejtat kombëtare. Nga ana tjetër, kryeministri hungarez Viktor Orban, beson se BE-ja ka komplotuar kundër vlerave dhe kulturës evropiane. Ai ka kritikuar në mënyrë specifike politikën liberale të emigracionit të kancelares gjermane Angela Merkel dhe investitorit miliardë dhe filantropist Xhorxh Soros, i njohur gjerësisht për financimin e OJQ-ve të majta, si në Europë ashtu edhe në Shtetet e



Bashkuara. Për këtë qëllim, vetë qeveria ka nisur fushata publike me moton: "Mos lejoni që Xhorxh Soros të qeshë i fundit". (Ndonëse është e vërtetë që Soros, ka ndërhyrë që Hungaria të pranojë më shumë emigrantë, këta të fundit janë duke e përdorur këtë vend si tranzit për të shkuar në Gjermani).

Bashkimi Europian, ka qenë kritik ndaj Orbanit, sepse ndër arsyet e tjera, për shkak të përpjekjes së tij për të çrrënjësuar atë që ai e quan "ndërhyrje e huaj", Budapesti ka goditur liritë civile. OJQ-të që marrin

para nga jashtë Hungarisë, përbalen me sfida të mëdha, duke përfshirë edhe projektligjin e qeverisë së ashtuquajtur "Stop Sorosit", që imponon një taksë prej 25 për qind mbi donacionet e huaja ndaj OJQ-ve që mbështesin emigracionin. OJQ-të e cilësuar si një "kërcënim për sigurinë kombëtare", mund të nxirren tërësisht jashtë ligjit. Ideja se në një vend njihet e drejta e shprehjes së lirë, nuk gjen "miq" aktualisht në Budapest. Para zgjedhjeve parlamentare në Hungari më 8 prill, Orban e mprehu to-

**Debati është ende me tone të ulta, pasi kushdo që guxon të pajtohet me këtë vendim quhet racist dhe nacionalist, përfshirë ata që kanë shqetësime legjitime për sjelljen e qeverisë hungareze dhe në Bashkimin Europian. BE i ka shpallur luftë Hungarisë për të gjitha të drejtat, dhe për të gjitha arsyet e gabuara**



nin e tij populist, për të siguruar një shumicë tjetër absolute në parlament.

Në lidhje me kundërshtarët e tij ideologjikë që finanohen nga Soros, ai tha: Ne po luftojmë kundër një armiku që është ndryshe nga ne. A nuk shfaqet hapur, por qëndron i fshehur; është jo i drejtpërdrejtë, por dinak; jo i ndershëm, por mashtrues; jo kombëtar por ndërkombëtar; nuk beson tek puna, por spekulon me paratë; nuk ka vendlindjen e vet, por mendon se zotëron tërë botën. Kjo lloj retorike, nuk ka vend në fushën e demokracive liberale. Dhe kjo ndoshta nuk e shqetëson Orbanin, i cili në vitin 2014, tha se donte të krijonte një shtet joliberal. Hungaria ka patjetër problemet e saj. Por procedura e nisur nga Parlamenti Europian, nuk ka të ngjarë të përmirësojë situatën atje. Neni 7 i Traktatit të Lisbonës (i cili ka diktuar funksionimin e BE-së që nga viti 2009), i lejon Parlamentit Europian të nisë një procedurë kundër një shteti anëtar, që nuk përmbush kriteret mbi të cilat ka rënë fillimisht dakord kur u bë pjesë e unionit. Pasi nis procedura, Komisioni Europian heton situatën. Këshilli Europian (i cili përfaqëson

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 25 shtator | Numri i parë i gazetës do të më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

shtetet anëtare të BE), voton pastaj nëse do t'i heqë vendit në fjalë të drejtën e votës brenda këshillit. Propozimi mund të miratohet, vetëm nëse vendet e tjera votojnë në favor me një shumicë prej 4/5 (Hungaria nuk mund të votojë për veten). Fakti që është evokuar neni 7, tregon mosbesimin e BE-së ndaj Hungarisë, veprim që vetëm sa do ta distancojë më shumë Budapestin nga Brukseli. Nëse Bashkimi European do të donte realisht të zhdukte frikën e Hungarisë nga ndërhyrjet e huaja, duke treguar se emigracioni jashtë BE-së do të mbetet kompetencë e shteteve anëtare, mund ta bënte këtë thjesht duke e ripohuar këtë parim.

Por Brukseli nuk e bën këtë, sepse është aktualisht nën presion nga Italia, e cila dëshiron të shpërndajë emigrantët në të gjithë Europën. Kjo do t'i bënte të ndiheshin të justifikuar hungarezët, që besojnë në goditjen e lirisë së tubimit dhe fjalës së lire, për të parandaluar ndërhyrjen e huaj. Çfarë do të thotë kjo? Bashkimi European është në pikën e përçarjes. Emanuel Makron, po bën thirrje për reformat e tij ambicioze të së ardhmes.

Angela Merkel gjendet në mesin e një zenke të brendshme politike mbi emigracionin, që do ta bëjë atë t'i rezistojë këtyre reformave. Qeveria italiane, po kërkon ndryshime të thella mbi emigracionin, dhe kërcënon të ndërpresë financimin për BE. Dhe vendet e Europës Qendrore, janë gjithnjë e më skeptike për centralizimin e pushteteve në Bruksel. E gjitha kjo po ndodh përkrah Brexit, i planifikuar në marsin e vitit të ardhshëm, dhe negociatave për pranimin e Maqedonisë, Malit të Zi, Shqipërisë dhe Serbisë, të cilat nuk janë ende gati për t'iu bashkuar unionit, sipas vëzhguesve të vet BE-së. Në vend se të merret me këto çështje në një mënyrë racionale, dhe duke pasur parasysh se BE-ja thjesht mund të ketë shumë pushtet, dhe duhet të zvogëlojë kompetencat e saj në fusha të ndryshme, duke ripohuar të drejtat kombëtare, Brukseli tani po kërkon të përjashtojë anëtarët e saj nga vendimet e mëdha. Debati është ende me tone të ulta, pasi kushdo që guxon të pajtohet me këtë vendim quhet racist dhe nacionalist, përfshirë ata që kanë shqetësime legjitime për sjelljen e qeverisë hungareze dhe në Bashkimin European. BE i ka shpallur luftë Hungarisë për të gjitha të drejtat, dhe për të gjitha arsyet e gabuara. Ajo mund ta fitojë këtë luftë, vetëm nëse i lejon shtetet anëtare të debatojnë hapur.

(American Conservartive)

# Kriza financiare e 2008-ës: Ku shkuan gjithë ato para?



Nga  
Eric RAUCHWAY

Shenjat paralajmëuese të një krize epike financiare, po shfaqeshin në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit 2008. Sigurisht, për ata që po i kushtonin vëmendje të madhe. Një element? Sipas bazës së të dhënave të "ProQuest", fraza "që nga Depresioni i Madh" u shfaq në gazetën Nju Jork Tajms, pothuajse 2 herë më shumë në 8 muajt e parë të atij viti, në krahasim me 1 vit të tërë të zakonshëm.

Në fillim të shtatorit, këto referenca nervoze nisën të shtohen ndjeshëm, duke u shfaqur në kolonat e faqes së parë të gazetave. Në mes të shtatorit katastrofa shpërtheu, në mënyrë dramatike dhe në një pamje të plotë publike. Lajmet financiare u bënë kryelajmi, ngaqë qindra punonjës të bankës "Lehman Brothers" mësynë trotuarët e Seventh Avenju në Manhattan, duke bartur orenditë e zyrave të tyre, duke u përpjekur t'u shpjegonin gazetarëve të etur kthesën tronditëse të ngjarjeve. Pse një bankë investimesh 158 vjeçare, një bankë e Uoll Stritit, do të falimentonte? Dhe çfarë do të thoshte kjo për shumicën e planetit? Vlerësimet sipërfaqësore nga politikëbërësit e Uashingtonit, nuk ndihmuan në qartësimin e situatës. Sekretari i thesarit, Henk Poson, kishte deklaruar se "sistemi financiar, mund t'i mbijetonte rënies së Lehman". Me fjalë të tjera, qeveria amerikane vendosi të mos veprojë për shpëtimin e bankës, ashtu siç kishte bërë me konkurrentët e Lehman, Merrill Lynch, gjigantit e sigurimeve American International Group (AIG) ose në pranverën e vitit 2008, me bankën e investimeve Bear Stearns.

Lehman, mendonin ata, nuk ishte një bankë shumë e madhe që të falimentonte. Presidenti i atëhershëm Xhorxh W. Bush, nuk kishte shpjegime. Ai mund të nxiste vetëm kurajon. "Në një periudhë afatshkurtër, rregullimet në tregjet financiare, mund të jenë të dhimbshme - si për njerëzit e shqetësuar për investimet e tyre, ashtu edhe për punonjësit e kompanive të prekura" - tha ai, duke u përpjekur të shuajë panikun potencial në Main Street. Privatist, ai dukej më pak i sigurt, duke u thënë këshilltarëve: "Një ditë do të më duhet të më tregoni se si kemi përfunduar me një sistem të tillë... Nuk po bëjmë diçka të drejtë, nëse jemi të mbërthyer tek këto opsione mjera-ne". Dhe për shkak se sistemi ishte bërë i ndërvarur globalisht, kriza financiare amerikane u përshkallë-

zua në një kolaps ekonomik mbarëbotëror. Pra, çfarë ndodhi? Kriza financiare e vitit 2008, e pati origjinën e vet në tregun e shtëpive, që kanë qenë ndër breza guri themeltar simbolik i prosperitetit amerikan. Politika federale, e përkrahu realisht ëndrrën amerikane të pronësisë së shtëpive që nga viti 1930, kur qeveria amerikane filloi të mbështeste tregun e pasurive të patundshme. Ajo vazhdoi më tej pas Luftës së Dytë Botërore, duke u ofruar veteranëve shtëpi me kredi të lira, përmes një projektligji të posaçëm të miratuar nga qeveria.

Politikëbërësit arsyetuan, se mund të shmangnin rikthimin në kushtet e rënda të paraluftës, përdërisa territoret e pazhvilluara për rreth qyteteve mund të mbusheshin me shtëpi të reja, dhe shtëpitë e reja me pajisje të reja, dhe rrugët e reja me makina të reja. Të gjitha këto blerje të reja, nënkuptonin punë të reja dhe siguri për gjeneratat që do të vinin. Dhe kjo deri vetëm gjysmë shekulli më pas, kur tregu i shtëpive po "shpërthente". Sipas Raportit Përfundimtar të Komisionit Kombëtar për Shkaqet e Krizës Ekonomike dhe Financiare të Shteteve të Bashkuara, midis viteve 2001-2007, borxhi për blerjen e banesave të reja u rrit gati po aq sa kishte në pjesën e mbetur të historisë së kombit. Njëherazi, çmimet e shtëpive u dyfishuan. "Ushtritë" e shitësve të pasurive të patundshme, u përpoqën që amerikanët të huazonin më shumë para për shtëpitë - ose edhe për shtëpitë e mundshme. Shumë shitës nuk i kërkuar huamarrësve asnjë dëshmi të të ardhurave, punës apo atë çka mund të linin si kolateral.

Pastaj shitësit u zhdukën, duke lënë një debitor të ri që mbante në dorë çelësat e një shtëpie të re, me ndonjë dyshim të zbehtë nëse marrëveshja ishte shumë e mirë për të qenë e vërtetë. Shitësit mund t'i bënin këto marrëveshje, pa hetuar aftësinë e një huamarrësi ose vlerën e një prone, sepse huadhënësit që përfaqësonin nuk kishin ndër mend të mbanin për vete barrën. Ata do t'i shisnin më tej këto tituj pronësie; bankierët do t'i "paketonin" ato në letra me vlerë, dhe do t'ia shpërndanin investitorëve institucionalë të etur për fitimet që tregu amerikan i shtëpive, kishte dhënë në mënyrë të qëndrueshme që nga vitet 1930. Pronarët e fundit të një banese, do të ishin shpesh mijëra kilometra larg, dhe as që ishin në dijeni të asaj që kishin blerë. Ata dinin vetëm se agjencitë e vlerësimit, u kishin thënë se prona e tyre e re ishte po aq e sigurt sa kishin qenë gjithnjë shtë-

Kongresi u garantoj një mënyrë për ta bërë këtë në vitin 2000, me Aktin e Modernizimit të Mallrave të Ardhshme, ku në thelb dy palë mund të bien privatisht dakord për çmimin e një asemi. Por në një spirale gjithnjë e në rritje, letrat me vlerë të shtëpive të blera humbën vlerësimet e tyre AAA, dhe bankat falimentuan. Presidenti Xhorxh W. Bush ishte një republikan konservator, që së bashku me shumicën e të emëruarve të tij, besonte tek virtytet e liberalizimit



pitë, të paktën që nga koha e Depresionit.

Për të parandaluar përsëritjen e Depresionit të Madh, qeveria amerikane i vuri bankat nën një rregullim të rreptë. Frenklin Ruzvelt kishte bërë fushatë për këtë çështje si pjesë e "New Deal" të tij në vitin 1932. Ai dhe partia e tij e mbajtën këtë premtim. Në fillim, ata siguruan bankat tregtare dhe depozituesit nëpërmjet Korporatës Federale të Sigurimit të Depozitave (FDIC). Pastaj, me Aktin Bankar të vitit 1933 (Akti Glas-Stigëll), ata i ndanë këto institucione të reja të sigurta nga bankat e investimeve, që morën pjesë në nisma financiare më të rrezikshme. Për dekada të tëra, një rregullim i tillë kufizues funksionoi.

Ky gjendje e qëndrueshme, vazhdoi deri në fund të viteve 1970, kur politikanët që shpresonin të gjallëronin një ekonomi në stanjacion, nxitën liberalizimin. Gjatë disa dekadave, politikëbërësit u distancuan nga Akti Glas-Stigëll. Pjesa më e madhe e asaj që mbeti prej tij, u shfuqizua në vitin 1999 me aktin e Kongresit, që lejonte bankat e mëdha tregtare, të ishin "mëma" të institucioneve financiare më të vogla dhe më të specializuara. Këto të fundit, kërkonin tani mënyra më të rrezikshme dhe më të ndërlikuara për të fituar. Kongresi u garantoj një mënyrë për ta bërë këtë në vitin 2000, me Aktin e Modernizimit të Mallrave të Ardhshme, ku në thelb dy palë mund të bien privatisht dakord për çmimin e një asemi. Por në një spirale gjithnjë e në rritje, letrat me vlerë të shtëpive të blera humbën vlerësimet e tyre AAA, dhe bankat falimentuan. Presidenti Xhorxh W. Bush ishte një republikan konservator, që së bashku me shumicën e të emëruarve të tij, besonte tek virtytet e liberalizimit.

Por me një krizën që përfshiu sistemin, Bush dhe "ushtarët" e tij, veçanërisht Sekretari i Thezarit Polson dhe kreu i Rezervës Federale Ben Bernanke, vendosën të mos rrinin duarkryq. Megjithëse nuk i kërkohej nga ligji për të shpëtuar Bear, Fannie ose Freddie, ata e bënë këtë për të shmangur katastrofën. Fundjavën e 13-14 shtatorit të vitit 2008, Lehman u rrënuar përfundimisht, me ndosh-ta dhjetëra miliardë dollarë asete të mbivlerësuar në bilancet e saj. Çdokush që zotëronte ende letrat me vlerë të Lehmanit, me supozimin se qeveria do ta shpëtonte, do të gënjente veten. (bota.al)

(Eric Rauchway është autor i disa librave mbi historinë amerikane, përfshirë "Lufta e dimrit dhe krijesit e parave")

Nëse askush nuk i dha një vëmendje serioze të ardhmes përpara referendumit, tani po shohim se largimi nga BE-së është një lloj sikur të hidhedh nga një dritare në lartësi, jo të sigurt nëse ajo që shihet poshtë është një shtrat i butë me pupla apo copa shkëmbinjsh

Në fillim të muajit korrik, Tereza Mej e mblodhi kabinetin e saj në 'Chequers', rezidencën e kryeministrit britanik, 40 milje larg nga Downing Strit, ku Uinston Çerçill shpëtoi dikur nga sulmi ajror gjerman mbi Londër, për të planifikuar luftën kundër nazistëve, dhe për të parë Vëllezërit Marks.

Ata gjendeshin atje për të diskutuar kushtet mbi të cilat Mbretëria e Bashkuar do të largohet nga Bashkimi Europian: çështje komplekse dhe kontestuese që e kanë ndarë vendin, veçanërisht konservatorët e zonjës Mej, dhe jo më pak ministrat e saj.

Ajo dëshironte t'i jepte fund këtyre grindjeve, dhe në fakt u kujtoi ministrave atë që Lordi Melbörn, kryeministri i parë i Mbretëreshës Viktoria, i tha më 1830ë-n kabinetit të tij: "Nuk është shumë e rëndësishme ajo që themi, por mendoj se të gjithë duhet të themi të njëjtën gjë!"

Për të zbehur kundërshtitë, ministrat që shkuan në Chequers, gjetën në sallë një pirq letrash me numrat e kompanive lokale të shërbimit taksit, një kujtesë jo shumë elegante se nëse ata zgjidhinin të jepnin dorëheqjen, nuk do të kishin më në dispozicion limuzinat e rehatshme qeveritare, për t'u kthyer në shtëpi.

Presioni duket se funksionoi. Mbrëmjen e së premtes, u arrit një kompromis i njohur si "Plani Checkers"—që propozonte plot optimizëm se Mbretëria e Bashkuar do të mund të qëndrojë në një zonë të tregtisë së lirë me BE-në, për mallrat industriale dhe bujqësore — ndërsa Ministri i Jashtëm, Boris Xhonson, e sulmoi ashpër kryeministren.

Por Mej u nxitua të shpallte fitoren. Të dielën, Dejvid Dejvis, ministri përgjegjës për Brexit, dha dorëheqjen duke thënë se "Plani Checkers", ishte shumë i favorshëm për Brukselin. Pastaj të hënën, edhe Xhonson njoftoi dorëheqjen e tij. Pra, ajo që duhej të zbuste dallimet brenda partisë, vetëm sa i vuri më në dukje ato.

Mej përballet tani me Konferencën e Partisë Konservatore në fillim të tetorit, e cila, nëse Chequers është ndonjë lloj udhërrëfyesi, mëton të jetë një tejet helmuese. Kjo konferencë, do të pasohet dy javë më vonë nga samiti i BE-së në Bruksel për të rënë dakord mbi kushtet përfundimtare, nëse do të ketë ndonjë marrëve-

"NEWREPUBLIC"

# SI U SHNDËRRUA BREXIT-I, NË NJË CIRK POLITIK



shje, për largimin zyrtar të Mbretërisë së Bashkuar nga Bashkimi Europian më 29 mars, ditën e Brexit.

Në Angli, kishte shumë arsye se përse njerëzit kishin nisur të mos pëlqenin "Europën", nga ksenofobia, tek një kritikë e ndershme ndaj BE-së, si një kartel i korruptuar. Liberalët, shpërfillin kollaj njerëz e klasës punëtore, të cilët kanë ankthe të kuptueshme në një epokë të industrive tradicionale të ndryshuara, dhe pagave që po nuk rriten më.

Por, si pasojë e takimit në Chequers, Brexit ka ofruar sërish një mundësi për manovra politike, ose për shfaqjen hapur të ambicieve. Çështja e "Europës", ka trazuaer konservatorët për shumë vite, dhe jo vetëm ata. Si kryeministër në vitin 1975, Harold Uilson u rrënuar si pasojë e përçarjes mbi Europën brenda Partisë Laburiste. Ai tentoi zgjidhjen e problemit duke mbajtur një referendum, i pari në vend, për vijimin e anëtarësimit në BE.

Uilson korri një fitore dërrmuese, 67 për qind pro dhe 33 kundër. Tridhjetë vjet më vonë, Toni Bler arriti një marrëveshje korruptive private me eurofobikun Rupert Murdoch, dhe me tmerrin e mbështetësve të tij më të afërt, premtoi një referendum mbi Kushtetutën e re Evropiane.

Në këmbim, ai garantoj mbështetjen e tabloidit të njohur të Murdoch, "The Sun", në zgjedhjet e përgjithshme që u mbajtën në pranverën e ardhshme të vitit 2005. Pasi fitoi zgjedhjet, Bler e harroi çështjen e referendumit.

Kur Dejvid Kameron u bë kryeministër në vitin 2010, ai u përball me problemin e tij të "Europës".

Deputetët e tij konservatorë, përfshinin një pakicë të zhurmshme që ishte armike e hapur e Bashkimit Evropian. Për 5 vjet, ai udhëhoqi një qeveri të konservatorëve në koalicion me liberalët demokratë, duke iu kërkuar kritikëve të tij të krahut të djathtë, të "ndalnin sulmet ndaj Europës".

Pastaj në zgjedhjet e vitit 2015, ai fitoi një shumicë të drejtpërdrejtë parlamentare, gjë që paradoksalisht e dobësoi pozitën e tij: Ai nuk mund të përdorte më liberal demokratët, për të mbajtur nën fre nxitësit e Brexit në partinë e tij. Si pjesë e përpjekjes së tij për "modernizimin" e partisë, Kameron paraqiti një projektligj për lejimin e martesës së personave të të njëjtit seks, pavarësisht pakënaqësisë së thellë të shumë prej deputetëve të tij, që në fund të fundit, quhen konservatorë.

Premtimi i një referendumi nga Kameron për qëndrimin ose jo në BE, u ofrua për të qetësuar mbështetësit e krahut të djathtë. Në mungesë të mashtrimit si ai i Uilson, apo paturpësisë së Blerit, Kameron shpresonte se nuk do t'i përmbahej premtimeve të tij për referendum, ose se do të fitonte opsioni i qëndrimit në union.

Pavarësisht pretendimeve të gënjeshtërtë të mbështetësve të Brexit, se Anglia i kishte të gjitha kartat në rregull, u bë gjithnjë e më e qartë se është BE-ja ajo që i jep tonin bisedimeve.

Shtetet anëtare të BE-së, nuk kanë pse t'i japin britanikëve kushte të preferuara të tregtisë, ose të drejtën e banimit për qytetarët britanikë. E pse duhet ta bëjnë këtë?

Cilado qoftë analiza ekonomike, udhëheqësit europianë kanë arsye shumë të mira politike, për të kërkuar një divorc të keq, që e bën Brexit-in të dhimbshëm për Anglinë, dhe një paralajmërim të tmerrshëm ndaj partive të tyre eurofobike—Alternativa për Gjermaninë, dhe Frontin Nacional në Francë, mbi pasojat e lëkundjes së "anijes" europiane.

Tani po shohim zbehjen e besimit të pabazë të mbështetësve të Brexit. Xhejkob Ris-Mog, një deputet konservator dhe financier i pasur, është një lider i angazhuar, që ka orkestruar një letër të përbashkët të më shumë se 60 deputetëve të partisë së tij, duke u thënë atyre "Chuck Checkers".

Ndërkohë, ai thotë se përfitimet nga Brexit nuk mund të jenë të dukshme pa kaluar 50 vjet, ndërsa 'Somerset Capital Management', fondacioni që e bëri atë të pasur, ka zhvendosur një pjesë të veprimtarisë së tij në një off-shore në Dublin, ku mund të vazhdojë të gëzojë përfitimet nga tregu i vetëm i BE-së.

E gjitha kjo përkeqëson pozitën e Tereza Mejit. Edhe nëse ajo do të ketë kryeministër deri në "Brexit Day", nuk ka gjasa të vazhdojë në këtë detyrë edhe për shumë kohë. Ajo është tani në detyrë, por jo në pushtet, pa autoritet dhe respekt nga ministrat dhe

deputetët e saj, si dhe shumica e elektoratit.

Nëse ajo do të qëndrojë edhe për disa kohë, kjo do të ndodhë për shkak se konservatorët janë të prirur për një garë të egër të brendshme për udhëheqjen e partisë. Por, nëse Europa do të shkatërrojë pozitën e zonjës Mej, ajo s'do të jetë viktimë e saj e parë. Çështja e Europës, e çoi Margaret Theçerin drejt akteve të çmendura, gjr që pastaj çoi në rënien e saj, dhe dëbimin brutal nga deputetët e saj më 1990-ën.

Askush, më së paku Mej, nuk e di se çfarë do të sjellë Brexit: një epokë e re të artë të prosperitetit, apo ndaljen e punës nga industria britanike, për shkak të radhëve të gjata dhjetëra kilometrike të kamionëve që qëndrojnë jashtë portit të Kalesë në Francë. Tashmë, 'Plani Chequers' po shpërbëhet.

"Ne kemi hyrë në betejë, me flamurin e bardhë që valëvitet mbi tankun tonë të parë që i prin kolonës"—shkroi Boris Xhonson mbi planin e zonjës Mej në fillim të shtatorit, dhe tani është formuar një konsensus, sipas së cilit parlamenti nuk ka gjasa ta miratojë atë.

Nëse askush nuk i dha një vëmendje serioze të ardhmes përpara referendumit, tani po shohim se largimi nga BE-së është një lloj sikur të hidhedh nga një dritare në lartësi, jo të sigurt nëse ajo që shihet poshtë është një shtrat i butë me pupla apo copa shkëmbinjsh. Shumë shpejt, ne mund të mësojmë realitetin e hidhur të një Brexit-i të ashpër.

JETËSË ASHPËR NË PRESHEVË I SHTOHET EDHE NJË PROBLEM



# SHQETËSIMI PËR KUFIRIN

Në luginën kufitare të Preshevës, as shqiptarët e as serbët nuk i kushtojnë shumë vëmendje temës për ndryshimin e kufirit mes Kosovës dhe Serbisë - ata janë shumë të zënë në përpjekjen për të zhvilluar një jetesë normale. Kështu e fillon shkrimin agjencia franceze e lajmeve, AFP, për luginën e Preshevës dhe për temën e korrigjimit të kufirit midis Kosovës dhe Serbisë. Në vijim po ju sjellim shkrimin e plotë të AFP-së

Një nga rajonet më të varfra të Serbisë, Presheva në vitin 2001 ka pasur një konflikt të shkurtër kur një grup gueril shqiptarësh të armatosur kërkoi që të bashkoheshin me Kosovën fqinje. Në vitin 2008, Kosova shpalli pavarësinë, por Serbia ende nuk e ka pranuar këtë, shkruan AFP, transmeton Koha.net. Por, këtë verë, presidenti i Kosovës Hashim Thaçi dhe ai i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, hapën temën e "korrigjimit të kufirit" për të zgjidhur problemet shumëvjeçare mes këtyre dy vendeve. Së fundmi, në media ka qarkulluar lajmi i një shkëmbimi të veriut të Kosovës - i banuar kryesisht nga serbët [Mitrovica e veriut], me luginën e Preshevës - një zonë jugore e Serbisë e banuar kryesisht nga shqiptarë.

Prej gjithsej 75.000 banorë në këtë luginë, 60.000 besohet se janë shqiptarë edhe pse ata bojkotojnë regjistrimet për popullsi të organizuara nga Beogradi.

Armët tani janë heshtur. Por e vendosur në mes të Serbisë, Maqedonisë dhe Kosovës - Lugina mbetet e goditur nga papunësia e lartë dhe e monitoruar nga shërbimet serbe të sigurisë. Edhe pse nuk ka figura zyrtare, në këtë luginë operojnë qindra ushtarë dhe policë. Kompanitë e mëdha nga ish-Jugosllavia tashmë janë zhdukur, siç ishte fabrika e plastikës "7 Korriku", fabrika e shtypshkronjës "Grafofleks", kompania tregtare "Buduçnost" dhe një fabrikë për paketimin e duhanit. Sipas shifrave zyrtare të tanishme, në luginën e Preshevës papunësia është rreth 70 për qind.

## EKSODI

Fasadat e shkatërruara të Preshevës dëshmojnë mjerimin. Paga mesatare mujore mezi arrin në 100 euro. Në qytetin tjetër të luginës, Bujanoc, ku kompania e ujit mineral "Heba" ofron punë, paga mesatare është 200 euro - përgjysmë më pak sa është mesatarja e pagës mujore në tërë Serbinë. "Pa perspektivën për punë, të gjithë do të përfundojmë duke u larguar", ka thënë për AFP Jonuz Kamberi, 24 vjeçar, përcjell Koha.net. Metalpunuesi i papunë nuk kishte për të thënë shumë në lidhje me shkëmbimin e territoreve. "Megjithatë, ata nuk do të pyesin për mendimin tim", tha ai.

Një shkëmbim territori do të ishte "buddallallëk", tha Bratislav Trajković, serbi 64 vjeç nga fshati multietnik i Reljanit. "Çfarë në të vërtetë na duhet është puna. Dhe të gjithë (serbët dhe shqiptarët) mendojnë njëjtë", ka thënë Trajković, një nëpunës civil. Të dyja palët janë nën presion nga Brukseli për të arritur një marrëveshje. Serbia është duke negociuar për t'iu bashkuar Bashkimit Europian. Kosova dëshiron të hapë bisedimet për anëtarësim me bllokun dhe po ashtu t'i bashkohet Kombeve të Bashkuara. Në fshatin Slavujevac, të gjithë, 500 banorë, janë serbë. Stojan Nedeljković, 55 vjeç, ka thënë se beson që një linjë e re kufitare "nuk do të zgjidhë problemet, as për serbët e as për shqiptarët". "Shqetësimi kryesor është se njerëzit nuk kanë mjete për të jetuar", shtoi Nedeljković, një baba i papunësuar i pesë vajzave, shkruan AFP.

## FABRIKA DO TË NDRYSHOJË GJITHÇKA

"Një fabrikë do të ndryshonte gjithçka", tha shoku i tij Nenad Gjorgjeviq, metalpunuesi 55 vjeç. Por nëse nuk ndryshona asgjë "të gjithë fëmijët do të largohen", shtoi Gjorgjeviq, i cili punon në një fabrikë që drejtohet nga një shqiptar.

"Nga 130 shtëpi në Slavujevac, rreth 40 prej tyre janë bosh ndërsa në të tjera jetojnë kryesisht pleqtë", tha ai. Armend Aliu, zëvendës-kryetar i komunës së Preshevës, 40 vjeç, tha se shteti serb "injoroi kërkesat e thjeshta" të tilla si një zonë industriale për të tërhequr investitorë, një kalim të ri kufitar me Maqedoninë dhe një librat shkollorë në gjuhën shqipe. Mosveprimi i Beogradit mund të nxisë aspiratat nacionaliste, tha Aliu.

Por, ndjenjat kombëtare vështirë që i lë Fadili, një shqiptar mbi të 60-tat, i cili erdhi në Bujanoc për të bërë pazar. "Pensioni im në Serbi është 300 euro dhe më kanë thënë se në Kosovë do të jetë rreth 50 euro", ka thënë Fadili, i cili nuk ka dashur ta zbulojë mbiemrin e tij.

Rreth 100 kilometra në veriperëndim, në Kosovë, Nazmi Aliu, një zjarrfikës i pensionuar 71 vjeç, po ashtu ka frikë se lëvizja e kufirit do ta vendosë atë nën sundimin e Beogradit. Aliu jeton në Suhodoll, një fshat shqiptar në rajonin e Mitrovicës veriore. Enklava kryesisht serbe ka një gjë të përbashkët me Preshevën: varfërinë e rëndë, shkruan AFP. "Investimi i madh në sektorin privat po mungon në rajon", sipas raportit për ekonomi të bërë në vitin 2015 nga Instituti Riinvest.

"Ndhima e vlefshme vjen kryesisht nga donatorët ndërkombëtarë dhe agjencitë qeveritare", shkruan AFP. Adnan Jusufi, 42 vjeçari i papunë, ka thënë se shkëmbimi i territoreve do ta përkeqësonte situatën më shumë. Ai dyshon se Serbia do të tregojë më shumë shqetësim për shqiptarët në Mitrovicën veriore. Shqiptarët nga Mitrovica veriore "nuk kanë punë, nuk kanë shkollë" dhe varen nga "kujdesi qeveritar", ka thënë ai.

## Kryeministrja me foshnjën tre muajshe në OKB

Akreditimi për foshnjën e kryeministres Jacinda Ardern ka qenë i titulluar "Bebja e Parë e Zelandës së Re"



Kryeministrja e Zelandës së Re, Jacinda Ardern, ka tërhequr vëmendjen e opinionit, pasi në mbrëmjen solemne në selinë e Kombeve të Bashkuara në New York, u paraqit bashkë me foshnjën e saj tre muajshe Neve Te Aroha. Në prag të sesionit të rregullt të 73-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në New York, u mbajt Samiti i Paqes, kushtuar 100 vjetorit të lindjes së ish liderit të Afrikës së Jugut, Nelson Mandela.

Vëmendjen më të madhe në mbrëmjen në fjalë, e tërhoqi shefja e qeverisë së Zelandës së Re, Ardern, e



cila gjatë gjithë kohës, mbante në duar beben tre muajshe. E përditshmja "Herald", shkruan se bashkeshorti i kryeministres, Clarke Gayford, i pranishëm në mbrëmjen, publikoi në Twitter akreditimin me të cilin bebes i është lejuar prania në event.

Akreditimi ka qenë i titulluar "Bebja e Parë e Zelandës së Re". "Për fat të keq, nuk munda t'i fotografoj fytyrat e befasuara të anëtarëve të delegacionit japonez kur hynë në dhomën ku po bënin ndërrimin e pampersit", shkroi Gayford. Kryeministrja Ardern, pritet t'i adresohet Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së më 27 shtator dhe nuk do të ishte aspak surprizë nëse sërish shfaqet në shoqërinë e "bebes së parë të Zelandës së Re".





Nga Qerim LITA

(vijon nga numri i kaluar)

Kërkesave të komunistëve jugosllav iu përgjigj personalisht Enver Hoxha, i cili në qershor të vitit 1944 u shkruante se udhëheqja e FNÇ-Sh-së dhe personalisht ai, në tërësi pajtoheshin që zhvillimet ushtarake kundër forcave nacionaliste shqiptare: “në sektorët e Dibrës, Peshkopisë, Librazhdit, Strugës, Kiçevës (Kërçovës - Q.L.), Gostivarit dhe Tetovës” të ishin të kombinuar. “Kemi bindjen - shkruante Hoxha - se ndërmarjet e përbashkëta do të japin rezultate të mira, do t'i japin një hov të ri luftës në atë sektor, do të mobilizojnë popullin e atyre krahinave rreth frontit nacional çlirimtar të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë dhe këto veprime të përbashkëta do të kenë reperkusione të thella në Kosovë, ku do të hapen perspektiva lufte të gjëra dhe pjesëmarrje më aktive në luftë të popujve të Kosovës në frontin nacional çlirimtar tuajin dhe në ushtrinë Glorioze të popujve të Jugosllavisë e udhëhequr me aq brio prej komandantit t'uaj të madh Mareshalit Tito”.

Menjëherë pas kësaj letre, pasojnë urimet e përzemërta si nga ShP i LNÇM-së, po ashtu edhe nga vetë Tito, drejtuar Enver Hoxhës. Në letrën përshëndetëse, që ShP i LNÇM-së ia dërgoi Hoxhës, veç tjerash thuhej: “Ne krenohemi dhe ia urojmë emrimin Komandantë Supremë, dhe gradën Gjeneral -kolonelë shokut Enver Hoxha, dhe i dëshirojmë sukses në luftën heroike që po e zhvillon populli shqiptarë dhe ushtria e saj heroike LNÇ nën udhëheqjen e djemve më të mirë të popullit Shqiptarë...”. Ndërsa, Tito, në letër, fillimisht shprehte “krenarinë e admirimin për luftën këmbëngulëse dhe të pakursyer të patriotëve shqiptarë për lirinë kombëtare kundër okupatorëve fashistë dhe veglave të tyre...”, për të vazhduar: “Ndërmjet vllazërimit me armë lindi dashurija e madhe midis popujve të Jugosllavisë dhe forcave çlirimtare të Shqipërisë...”.

Duhet theksuar se operacionet e përbashkëta të njësive komuniste jugosllav-shqiptare, në krahinën e Dibrës, nuk kishin për synim luftën kundër gjermanëve, por asgjësimin e njësive kreshnike, përkatësisht vullnetare shqiptare, që etiketoheshin si “forca reaksionare”. Këtë e shohim në urdhërveprimin e lëshuar më 3 korrik 1943 nga komandanti i Divizionit të I, Dali Ndreu, i cili parashihte: sulmin dhe asgjësimin e forcave zogiste, përkatësisht, nacionaliste nën udhëheqjen e Hysni Demës, Ismail Demës, Uke Camit etj, duke i goditur të njëjtat nga të tri anët

DIBRA E MADHE GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE (5)

# PUSHKATIMI PA GJYQ I NACIONALISTËVE SHQIPTARË



Tërheqja, përkatësisht, bashkangjitja e një pjese të njësive nacionaliste shqiptare me njësitë e LNÇ-së, si dhe tërheqja e gjermanëve (1 shtator 1944), mundësoi që në Dibër të Madhe me 2 shtator të futen njësitë partizane jugosllavo-shqiptare pa asnjë rezistencë. Menjëherë pas kësaj u vendos pushteti ushtarak jugosllav, i cili në emër të “grumbullimit të armëve”, si dhe në emër të “zbulimit të ballistëve”, arrestoi me dhjetëra veprimtarë të shquar shqiptar nga ky qytet me rrethinë, një pjesë e të cilëve u pushkatuan pa asnjë proces gjyqësor

nëpërmjet njësive të Divizionit I Sulmuese të FNÇSh-së. E. Hoxha në cilësinë e komandantit të përgjithshëm të UNÇ-së, më 6 korrik urdhëroi Divizionin I: “...Krerët e Dibrës të goditen me ashpërsi sikur Bazi” (Abaz Kupi -Q.L.). Menjëherë batalioni partizan i Dibrës nën komandën e Esat Ndreut me mbështetje edhe të Faik Shehut, po atë ditë sulmoi forcat nacionaliste e ato të gjandarmërisë shqiptare të Homeshit e të Peshkopisë dhe i morën këto qendra, ndërsa forcat e gjandarmërisë, mbas një qëndrese të vogël u larguan duke lënë mjaft të vrarë e të plagosur. Ndërmjet të vrarëve e të plagosurve ishte edhe komandanti i xhandarmërisë së Dibrës së Madhe, Myftar Kaloshi.

Duhet theksuar, se Peshkopia herë merrej nga njëra palë e herë nga pala tjetër. Kështu më 13 korrik ajo u morr nga njësitë partizane, ndërsa 2 ditë më vonë, përkatësisht më 13 korrik njësitë partizane pas një kundërsulmi të shpejtë nga njësitë e Halil Alisë, Hysni Demës etj, u detyruan të tërhiqen nga qyteti, për t'u vendos në Fushë Alië. Lidhur me zhvillimet luftarake në krahinën e Dibrës, Dali Ndreu, në letrën drejtuar Milladin Popoviqit

dhe Enver Hoxhës, vinte në pah rezistencën e madhe që hasën nga njësitë nacionaliste shqiptare: “Vetëm kalimi i ynë në Veri të Shkumbinit, -shkruante D. Ndreu- ka qenë një sukses, çdo qendresë e reaksionit asht shpartallue. Por nuk kemi mundun që ta detyrojmë në një luftim me stil të gjanë që të mundshim të kishim një sukses me të vërtetë ushtarak. Reaksionarët janë tërhequr dhe largue mbas një përpjekje të vogël. Asnji nga shtabet e këtyne nuk kemi mundun t'i zhdukim, t'i zajmë ose t'i vrasim (vetëm Miftar Kaloshin). Reaksioni ndër këto vende mbetet akoma dhe me largimin tonë, ngjallet dhe riorganizohet prap. Në Dibër po gjejmë qëndresë dhe nga populli, i cili në shumë vende ka qenë besëlidhur për mos me lanë me kalie forcat tona...”.

Përderisa në Dibër të Poshtme, zhvilloheshin luftime të ashpra midis njësive nacionaliste shqiptare dhe të FNÇSh-së, në anën tjetër, SHK i LNÇ-së për Maqedoni, urdhëroi njësitë e Brigadës I maqedonase dhe Brigadës I kosovare, që më datë 19 korrik 1944 të sulmojnë qytetin e Dibrës. Mirëpo, pas luftimeve të përgjakshme, të cilat zgjatën plot

katër orë, njësitë vullnetare shqiptare të ndihmuar edhe nga xhandarmëria arritën ta përballojnë sulmin, dhe pas një kundërsulmi të shpejtë e detyruan armikun të tërhiqet në drejtim të Karaormanit. Sulmi i njësive pushtuese jugosllave ndaj Dibrës së Madhe, siç pohon C. Uzunovski, erdhi në momentin kur në Peshkopi zhvilloheshin luftime të ashpra midis njësive kreshnike shqiptare dhe njësive të Divizionit të I të LNÇM-së:

“...Akoma deri sa nuk ishin vendosur lidhjet me Divizionin e I, -shkruante Uzunovski - kemi dëgjuar se...ballistët sulmuan Peshkopinë, ku ishte Divizioni. Për t'i dhënë një ndihmë vëllezërore, neve u dhamë urdhër njësive tona që të sulmonin Dibër...”. Marrja e Dibrës për udhëheqjen komuniste jugosllave ishte me interes të veçantë, për arsye se ata planifikonin që me pushtimin e kësaj krahine e më pas edhe të krahinës së Lumës, do të hapej korridori për depërtimin e njësive të tyre në Kosovë. Prefekti i Kukësit, Rrok Perrolli, më 29 korrik 1944, i raportonte MPB-së për disa përpjekje të çetave komuniste për t'u futur në territorin e atij qarku:

“Mbas shpartallimit të çetave

komuniste në Peshkopi e rrethet -thuhej në raport - ato kanë bërë përpjekje të futen në Qarkun e kësaj prefekturë, nga ana e Kalasë së Dodës, me masat e marruna me Kompaninë Shëtitëse, të cilën e kemi pasë dërgue për çdo eventualitet në kufirin Lumë-Peshkopi dhe me një shumicë vullnetarësh deri më 500 vetë të mbledhun nga ana e Osman Litës, mbasi ka hye në bjeshkë te stanet e Osman Litës, të cilat kanë dash të t'i djegin, por mbasi kanë pa fuqi aty..., çeta komuniste që ishte e kryesuar prej Haxhi Lleshit dhe Abedin Shehit, kanë këthye prap në rajonin e Peshkopisë, në Bjeshkën Gram dhe nga këndej kanë marrë drejtim për në kufirin Bullgar...”.

Dështimet e njëpasnjëshëm të forcave të koalicionit komunist për marrjen e krahinës së Dibrës e të Lumës, i shtynë udhëheqjet aleate jugosllavo-shqiptare për hartimin e një strategjie të re. Për këtë qëllim, ata krijuan shtabin e përbashkët operativ në përbërje: Video Smilevski - Bato (një shqiptar ortodoks i maqedonizuar nga Reka e Epërme), Petar Brajoviq të cilët përfaqësonin SHK të LNÇ-së për Maqedoni, ndërsa SHK të UNÇ-së e përfaqësonin Dali Ndreu dhe Mehmet Shehu. Pasi u bënë të gjitha parapërgatitjet e nevojshme, më 1 gusht 1944, njësitë e koalicionit në kuadër të së cilës u përfshinë: Brigada e I, IV dhe V shqiptare, Brigada I maqedonase dhe Brigada I kosovare, sulmuan sërisht Dibërën e Madhe, mirëpo pa ndonjë sukses, për arsye se ata hasën në një rezistencë të fuqishme nga njësitë nacionaliste e të xhandarmërisë shqiptare. Menjëherë pas këtij dështimi, reagoi pala jugosllave, e cila më 15 gusht përmes një letre të nënshkruar nga Petar Brajoviq dhe Mito Milkoviq, shprehte pakënaqësinë e sjelljes së njësive shqiptare pas dështimit për marrjen e qytetit të Dibrës:

“Bashkëpunimi që duhej të krijohej ndërmjet forcave tona dhe njësive të brigadave tuaja - thuhej në letër - në sektorin e Dibrës, nuk ka qenë ashtu siç u parashikua dhe e propozuar nga ana e shokut Komandant Enver Hoxhës. Pas sulmit pa sukses në qytetin e Dibrës, megjithëse ishte e parashikuar nga shtabi operativ i përbashkët, tërheqja e të gjitha forcave në drejtim të Karaormanit - kjo gjë nuk u bë, me qenë se forcat tona mbeten të veçuara, duke përbaluar ofensivën e madhe të armikut dhe duke patur bashkërisht 70 të plagosur. E sho-



fim të arsyeshme që të vazhdojmë punën e përbashkët për t'u arrijtur ajo që është parashikuar edhe nga ana e juaj...".

Për rrjedhojë, komandanti i Divizionit I, Dali Ndreu, më 17 gusht lëshoi një Urdhëresë deri te Shtabi i Brigadës V Sulmuese shqiptare, me këtë përmbajtje:

"Në lidhje me informatat na jepni për mbi vendosjen e armikut në qytetin e Dibrës, mbasi kemi ndërmend që të bëhen një veprim i kombinuem i forcave t'ona dhe të atyre Maqedhonase si dhe në bashkëpunim edhe me aviacionin aleat kundra qytetit të Dibrës duhet: Të merrni informata të sigurt mbi vendosjen ekzakte të forcave gjermane...Sa forca xhandarësh dhe mercenarësh ndodhen në qytetin e Dibrës. Të studiohen cilat janë pozitat më të përshtatshme të cilat mund të lejojnë ma me lehtësi sulmin dhe mbritjen e pozitave t'armikut. Në këtë studim duhet me mbajt parasysh se në dy sulmet e para qi janë ba qytetit armiku asht thye nga pozitat që ka pasë zënë jashta qytetit në mal dhe qe ska qenë i mundur likuidimi i tyre pse atje kanë pasë mjaft municion dhe studime. Prandaj duhet të studiohet që të mos lajm që forcat armike të thyera nga mali të tërhiqen për t'u bashku me forcat e tjera në kazerma por të ndahen pse mandej mund të likuidohen ma me lehtësi veç e veç. Për këtë qëllim kemi urdhëruar dhe artilerinë e Brigadës së I që të vihet në dizpozicionin t'uej...".

Ndërkohë, luftime të ashpra midis njësive partizane dhe atyre nacionaliste shqiptare u zhvilluan në Fushë Alie dhe fshatrave përreth. Beteja më e përgjakshme u zhvillua në fshatin Sinë, e cila zgjati plot dy ditë e dy net, ku pati shumë të vrarë e të plagosur nga ana e të dy palëve. Pas tërheqjes së forcave nacionaliste të cilave u prinin Halil Alia dhe Selim Kaloshi, njësitë e Brigadës së IV e të V partizane shqiptare dogjën thujtë të gjitha shtëpitë e fshatrave Sinë dhe Fushë Alie. "Në katundin Sinë - njoftonte zv. komisari i Brigadës V, Manush Myftiu - u dogjën pa asnjë arsye shtëpitë e katundit, vetëm për hakmarrje të shokëve të vrarë...Qëndrimi i përgjegjasve ushtarakë ka qenë shumë i keq, gjë që ka inkurajuar partizanët për të shkatërruar akoma ma keq, çfarë kishte mbetur nga zjarri...". Sjelljen brutale të njësive partizane shqiptare, ndaj banorëve shqiptarë të kësaj zone të Dibrës, më së miri përshkruhet nga njëri ndër drejtuesit kryesor të LNÇ-së në krahinën e Dibrës, Sulë Baholli:

"...Mandej forcat e bashkuara të Brigadës IV e V mësynë fushë Aliajn dhe i vunë zjarrin kullës së Halil Alisë, por vranë edhe dogjën edhe njerëz të pafajshëm...U dogjën të gjitha sahtëpitë e fshatit Fushë Aliaj, në vend që të digjeshin vetëm shtëpitë e reaksionarëve të shquar...".

Thyemja e parisë nacionaliste në Sinë e Fushë Alie, e cila siç u tha më lartë u përçoll me një sjellje tejet kriminale të njësi partizane sh-

qiptare si ndaj popullsisë civile po ashtu edhe ndaj pronave të tyre, e shtynë një pjesë të parisë nacionaliste të zhvillojnë negociata me udhëheqësit e UNÇSh-së e të UNÇJ-së. Kështu Dan Kaloshi, së shpejti u kyç në radhët e UNÇSh-së. Më 22 gusht, Dali Ndreu i shkruante komandantit të Brigadës I, Shefqet Peqit: "Siç u është theksuar edhe herë të tjera duhet t'i jepet randësi çështjes së mobilizimit të Divizionit I. Prandaj jepni Dan Kaloshit një kompani, mbasi ai ka mundësi mobilizimi e ka premtuar, dhe t'ia filloj me një herë mobilizimit për Brigadën e V".

Ngjashëm sikurse me Dan Kaloshin, u veprua edhe me Cen Elezin dhe djalin e tij Xhelal Ndreun. Për kyçjen e këtij të fundit në njësitë partizane, njoftohemi nga letra e Mehmet Shehut dërguar Shefqet Peqit: "...Xhelal Ndreu erdhi dhe biseduam gjërë e gjatë me të. Bëmë dakord që të shkojë si partizan i thjeshtë në Brigadën e I por për disa ditë e dërguam në Reç e Dardhë për të përfutur nga influenza e tij me kryerjen e mobilizimit e pastaj menjëherë do të shkoj në Brigadë...".

Bisedime të ngjashme u zhvilluan edhe në Dibër të Madhe dhe në Strugë, midis Uke Camit, Murat Labënishtit dhe Esad Dokës si përfaqësues të nacionalistëve shqiptar dhe Video Smilevski - Bato i cili përfaqësonte SHK të LNÇ-së për Maqedoni. Burimet e kohës vënë në dukje se në këto bisedime, është arritur marrëveshja gojore, sipas së cilës, Uke Cami, të mos u kundërvihet sulmeve të njësive partizane për marrjen e Dibrës, ndërsa Labënishti dhe Doko, t'i bashkojnë forcat e tyre me forcat partizane, por me kusht që "Struga me rrethinë pas çlirimit t'i takojnë Shqipërisë". Më vonë do ta shohim Esat Dokon në aradhat e forcave komuniste, përkatësisht, ai me grupin e tij do t'i bashkëngjitet Brigadës IV shqiptare dhe u angazhua në marrjen e qytetit të Strugës.

Përveç kësaj, V. Smilevski, në letrën të datës 24 gusht 1944, kërkonte nga SHK i UNÇSh-së që kjo e fundit t'i dërgoj të gjithë partizanët dhe udhëheqësit komunist shqiptar me prejardhje nga trevat lindore shqip-

tare, të cilat ata i konsideronin si treva jugosllave, përkatësisht maqedonase: "Lidhur me detyrën tonë, -shkruante Smilevski - për krijimin e njësive shqiptare në përbërjen e UNÇL të Maqedhonisë - në mënyrë që të shpejtojmë mobilizimin e banorve shqiptar në Maqedhoni dhe për të shpejtuar shktrimin e reaksionit shqiptar në Maqedhoni, nga njëra anë dhe në anën tjetër, t'u japim mundësi masave shqiptare që me armë në dorë të luftojnë kundër okupatorve fashist bashk me popullin vlla maqedhonas, është e nevojshme që të na dërgoni sa më parë në përbërjen e një njësie shqiptare të krijuar, të gjithë ata luftëtarë dhe udhëheqës, të cilët ndodhen në njësitë tuaja por që janë lindur në territorin e Maqedhonisë... Mëtej, Shtabi Kryesor i UNÇL e DP të Maqedhonisë ju propozon që në anë të një njësije tuaj, me forca të një brigade ose më të vogël, të operoni edhe më tej në territorin kufitar dhe në këtë mënyrë të lidhni ose të godisni njësitë shqiptare reaksionare për kohën ndërsa Brigada I Sulmuese e UNÇL të operojë në rajone tjera për spastrimin e territorit dhe për të bërë mobilizimin...". Të njëjtën ditë, Mehmet Shehu, urdhëroi që një batalion i Brigadës XVIII të dërgohet në rajonin e Kërçovës, për siç pohon: "ndihmë politike të Brig. Maqedhonase për të përballuar shovinizmin (shqiptar) në rrethet e Kërçovës...". rrjedhimisht, nga njësitë e këtij batalioni si dhe të ardhës partizane shqiptare e cila ishte themeluar më 14 gusht 1944 po në Kërçovë, më datë 26 gusht në malet e Karaormanit u formua Brigada e IV shqiptare, e cila fillimisht numëronte 450 luftëtarë, ndërsa me kalimin e kohës, ky numër do të shkojë deri në 5000. Më 7 janar të vitit 1945, brigada mori emër tjetër - Brigada e VII Sulmuese Shqiptare, e cila me 2.5000 luftëtarët e saj mori pjesë në Frontin e Sremit.

Tërheqja, përkatësisht, bashkangjitja e një pjese të njësive nacionaliste shqiptare me njësitë e LNÇ-së, si dhe tërheqja e gjermanëve (1 shtator 1944), mundësoi që në Dibër të Madhe me 2 shtator të futen njësitë partizane jugosllavo-shqiptare pa asnjë rezistencë.

Menjëherë pas kësaj u vendos pushteti ushtarak jugosllav, i cili në emër të "grumbullimit të armëve", si dhe në emër të "zbulimit të ballistëve", arrestoi me dhjetëra veprimtarë të shquar shqiptar nga ky qytet me rrethinë, një pjesë e të cilëve u pushkatuan pa asnjë proces gjyqësor. Ngjashëm sikurse autoritetet ushtarake jugosllave u sollën edhe ato shqiptare, që e pamë të arsyeshme ta paraqesim një rast tejet të dhimbshëm e të shëmtuar nga ana e artilerisë së Brigadës I, e cila pushtoi shtatë veprimtarë të nacionalizmit shqiptar nga krahina e Dibrës. Ekzekutimi i tyre u krye pa gjyq, vetëm me urdhër personal të Baba Fajës.

Po në këtë kohë, Mehmet Shehu, i shkruante Shefqet Peqit, për një proces gjyqësor në Dibër të Madhe, i zhvilluar nga Gjyqi ushtarak i përbashkët jugosllavo-shqiptar:

"Dilaver Camin, - shkruante Shehu - që ka qenë kapter xhandarmarije e kaluam para gjyqit dhe e li ruam, duke i marrë një deklaratë, dhe të gjithë të hollat që kishte marrë në dorëzim nga kapiteni i xhandarmërisë së Dibrës, nga të cilat të holla neve na takoi vetëm shuma 700 napoleona, dhe pjesën tjetër e muarën shokët maqedhonas të Dibrës. Disa të tjerë na kanë çuar fjalë se do dorëzohen. Selim Nokën, po e pushkatojmë para popullit në Dibër. Tahsimin mbarim urdhër ta nisim për në Shtabin e Përgjithshëm...".

Në mesin e të burgosurve ishte edhe komandanti i Zonës Operative I të LNÇ-së për Maqedoni, Hamdi Dema. Lidhur me burgosjen dhe më vonë vrasjen makabre të H. Demës, në një dokument të OZN-ës, thuhet: "Hamdi Dema: Si agjent e MK AbWKdO 310, është futur në LNÇ-ë në territorin Kërçovë-Dibër ku arriti deri te pozita komandant i Zonës operative I, i cili shkante në linjën e copëtimit të lëvizjes. Është burgosur dhe likuiduar në vitin 1944 nga të besuarit e OZN-ës gjatë përpjekjes së arratisjes nga burgu i Prilepit".

Me ripushtimin e Dibrës, njësitë partizane marshuan në drejtim të Lumës, ku me 5 shtator, njësitë e Brigadës V Sulmuese pushtuan Ka-

lanë e Dodës, ndërsa disa ditë më vonë u pushtua thujtë e tërë krahina, me çka u krijuan kushte për futjen në Prizren. Gjatë këtij marshimi, njësitë e kësaj brigade me urdhër të komandantit, Shefqet Peçi, kryen krime dhe masakra të papara ndaj popullsisë civile. Një masakër e tillë u krye ndaj banorëve të fshatit Buzmadhë, ku 21 burra të këtij fshati u pushkatuan pa asnjë proces gjyqësor. Lidhur me këtë masakër, zv. komisari Manush Myftiu, në Plenumin e Beratit shprehet: "Në Buzmadhë fshatarët patën një qëndrim jo të mirë ndaj nesh...Korparmata na dërgoi telegram në të cilën na urdhëronte të ndërmarrim masa, por të mos pushtojmë, dhe kjo neve nuk na ishte e qartë se si të veprimë. Shkuan Shefqeti (Peçi - Q.L.) dhe Çobani (Nito Çako - Q.L.) dhe unë ua sqarova se si të veprimë, përkatësisht se nuk guxojnë të ekzekutojnë. Ata kishin poseduar informata për qëndrim të keq të banorëve dhe të revoltuar atëherë pushkatuan 21 persona, përkajshatit...".

Krejt kjo sjellje e shëmtuar, nuk e pengonte komandantin e Korparmatis I Sulmuese Shqiptare, Dali Ndreut, dhe Hysni Kapon, që Sh. Peqit përmes një letre t'i shprehin fjalë miradie, për "sukseset" e arritura të Brigadës V në Veri të Shqipërisë: "Nga veprimet e zhvillueme në Veri keni shpartalluar forcat e okupatorit dhe keni zënë rob Zyber e Sherif Litën, ....Selim Nokën dhe tash së fundi armikun e Internacionales komunizmit e të popullit Shqiptar tradhtarin Zaj Fundo. Të gjitha këto suksese i shtojnë faqe lavdije historis së Brigadës V Sulmuese. Shpejtësia dhe guximi me të cilin keni zhvilluar këto veprime qëndrimi i drejtë me popullin dëshmojnë edhe një herë besimin e pa tundshme në Brigadën e V se asht në gjendje të kryej detyra edhe ma të vështira. Bashkëpunimi që së shpejti do të realizohet me ushtrinë Jugosllave, do t'u jap rastin të tregoni se edhe ushtria Nacional Çlirimtare e Komanduar nga Gjeneral Kolonel Enver Hoxha, asht e zonja të shkoj krahas me ushtrinë e Titos".

Në frymë të njëjtë shprehet edhe anëtarja e Byrosë Politike të PKSH-së, Liri Belishova, e cila në Konferencën e Rinisë komuniste ballkanike, të mbajtur më 15-16 janar 1945 në Shkup, thekson:

"...Vëllazërimin tonë me rininë jugosllave e kemi forcuar në luftën për Dibrën dhe në luftën e territoreve tjera jugosllave (shqiptare të cilat komunistët shqiptar ua falën jugosllavëve - Q.L.). Ne kemi bërë kumarti në burgjet, përkundër provokimeve të shumta, për të na detyruar të luftojmë kundër njëritjetrit, ta ngremë ushtrinë tonë nacionalçlirimtare kundër ushtrisë nacionalçlirimtare të Mareshalit Tito. Edhe përkundër të gjitha atyre përpjekjeve, ne nuk qëndruam kundër njëritjetrit, simpatia dashuria e rinisë shqiptare ndaj rinisë jugosllave, sot është shumë e madhe...".

(fund)



Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, si dhe në mbështetje të nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës, shpallet

### KONKURS

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës:

#### FAKULTETI FILOLOGJIK

##### Programi studimor Gjuhë dhe Letërsi

#### Angleze

1. Një mësimdhënës për lëndët:

- Letërsi angleze III
- Letërsi angleze IV
- Civilizim britanik
- Civilizim amerikan

##### Programi studimor Gjuhë dhe Letërsi

#### Maqedonase

1. Një mësimdhënës për lëndët:

- Pedagogjia dhe didaktika
- Metodologjia e punës shkencore
- Komunikimi ndërkulturor pedagogjik

#### FAKULTETI EKONOMIK

1. Një mësimdhënës për lëndët:

- Statistikë
- Vendosje biznesore

2. Një mësimdhënës për lëndët:

- Tregu i kapitalit
- Ekonomia monetare

3. Një mësimdhënës për lëndët:

- Bazat e kontabilitetit
- Kontabiliteti financiar

4. Një mësimdhënës për lëndët:

- Financat ndërkombëtare

- Financat publike

5. Një mësimdhënës për lëndët:

- Menaxhimi financiar
- Paraja dhe banka
- Ekonomia ndërkombëtare

6. Një mësimdhënës për lëndët:

- Menaxhimi financiar
- Menaxhimi i burimeve njerëzore
- Financat publike

#### FAKULTETI I SHKENCAVE

##### MJEKËSORE

1. Një mësimdhënës për lëndët:

- Patofiziologji
- Mjekësi interne

#### FAKULTETI I ARTEVE

1. Një mësimdhënës për lëndët:

- Historia e artit 1, 2, 3 dhe 4

#### FAKULTETI I SHKENCAVE

##### MATEMATIKE NATYRORE

1. Një mësimdhënës për lëndët:

- Fizika atomike
- Biofizikë (në programin studimor Fizioterapi)
- Mekanikë teorike

#### Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:

• Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;

• Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;

• Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;

• Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;

• Biografi e shkurtër;

• Ta dorëzojë punimin e doktoratës;

• Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;

• Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;

• Certifikatë nga libri amë i të lindurve;

• Certifikatë e shtetësisë.

\*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, të parapara me nenin 166 të Ligjit për arsimin e lartë.

\*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

Universiteti i Tetovës



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

#### SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 191/2018

për punësimin e 1 nëpunës publik nga grupi I, nëngrupi II në „Entin Nacional Biblioteka Universitare "Sh.Kliment Ohridski" - Manastir“ për vendet e punës në vijim:

1. KUL0102V01002 Këshilltar për punë administrative, të përgjithshme dhe juridike, Njësia - Organizuese - administrative dhe burime njerëzore, Sektori për punë administrative, të përgjithshme dhe juridike 1 realizues(ë)

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalesore për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- nivelet e kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Shkencat juridike; administratë publike dhe administratë
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

#### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

#### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

#### Orari i punës:

- Ditët e punës e hënë-e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30

Rroga neto: 20.579,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësimit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inicohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – rë.



SHOQËRIA AKSIONARE PËR NDËRTIM DHE EKONOMIZIM ME HAPËSIRË  
BANESORE DHE ME HAPËSIRË AFARISTE ME RËNDËSI PËR REPUBLIKËN  
– SHKUP



rr. Orce Nikolov nr. 138, Shkup, fahu postal 474 tel: 3111-387

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune („Gazeta Zyrtare e RM“ nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 dhe 120/18), Shoqëria aksionare për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup publikon:

#### Shpallje publike

Për nevojën e punësimit të punëtorëve për kohë të pacaktuar

Shoqëria aksionare për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup ka nevojë për punësim të 2 punëtorëve për kohë të pacaktuar për vendet e punës në vijim:

1. Për vendin e punës **“Referent për evidencë dhe arkivim të dokumentacionit**, Sektori për ekonomizim me hapësirë banesore, në **Filialin Shkup** të shoqërisë aksionare – 1 punëtor me PMP dhe 1 (një) vit përvojë pune pas marrjes së përgatitjes së kërkuar profesionale;

- Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte (40 orë), 8 orë pune në ditë (fillimi mes orës 7.30 dhe 8.00, mbarimi rreth orës 15.30 dhe 16.00), neto pagesa bazë 27.100,00 denarë.

2. Për vendin e punës **“Referent për pagesë”** në **Filialin Parking Qendra – Shkup** të shoqërisë aksionare – 1 punëtor me PMP - KU dhe 1 (një) vit përvojë pune pas marrjes së përgatitjes së kërkuar profesionale;

- Orari javor i punës është 40 orë, 8 orë pune në ditë, punë me 3 ndërrime (ndërrimi I prej ora 06 deri në ora 14, ndërrimi II prej ora 14 deri në ora 22 dhe ndërrimi III prej ora 22 deri në ora 06), neto pagesa bazë 24.200,00 denarë

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme në pajtim me ligjin si dhe kushtet e posaçme të parapara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës – Shoqërisë aksionare për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup edhe atë:

- të kenë arsim të mbaruar përkatës të theksuar në shpallje për vendin konkret të punës dhe 1 vjet përvojë pune që kandidati e ka kaluar në punë pas arritjes me përgatitjen e kërkuar profesionale.

**Kandidatët me fletëparaqitjen (me kontakt telefon dhe adresë) ku shënohet për cilin vend pune në shpallje paraqiten duhet të dorëzojnë dëshmi për plotësimin e kushteve të theksuara edhe atë:**

- Diplomë, certifikatë ose dëftesë për arsimin e mbaruar me përgatitjen e kërkuar profesionale (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter);

- Dëshmi për përvojën punës (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter);

- Certifikatë e shtetësisë (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter);

Afati për paraqitjen e kandidatëve është **3 (tre) ditë pune** nga dita e publikimit të shpalljes.

Fletëparaqitjet e dorëzuara me vonesë dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

**Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin dorëzohet në adresën e Shoqërisë aksionare për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup – Drejtoria, rr. “Orce Nikolov” nr. 138, Shkup, përmes postës ose në arkivin e shoqërisë aksionare çdo ditë pune prej ora 8.00-16.00.**

SHA për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup do të bëjë zgjedhjen e kandidatëve të paraqitur në afatin e paraparë ligjor (45, 90 ose 120 ditë), varësisht nga numri i fletëparaqitjeve të arritura. Personat për kontakt: Gj. Maneski/Z. Nedanovski, tel. 02/ 02/ 2 633 899, 2 633-833

Për ndeshjen ndaj Bellasicës, nuk kam shumë për të thënë, për shkak se duhet të luajmë si një grup, duhet të jemi të gjithë së bashku, njëri tjetrin ta ndihmojmë, që në fund të fitojmë për ekipin”, ka deklaruar Armel Bradji

Koha **Fisnik NUHIU**

Shkup, 25 shtator - Nuk ka pushim për ekipet e Ligës së Parë futbolistike të Maqedonisë. Në mesjavë vazhdojnë ndeshjet e javës së shtatë ku në program do të kemi pesë takime. Skuadra e FC Shkupi pas fitores ndaj Makedonija GJ.P të dielën sot do të udhëtojë drejt Strumicës ku do të përballlet me ekipin e Bellasicës të cilët në këtë përballje hynë të motivuar pas fitores si mysafire e Renovës me rezultat 2:0. Për përballjen e radhës ndaj Bellasicës, u prononcua futbolisti që këtë verë përforcoi mesfushën e Shkupit, Armel Bradji, i cili tregoi për atmosferën në klub dhe përballjen e të mërkurës. “Nga momenti që kam ardhur këtu, në këtë klub, atmosfera është shumë e mirë, klubi më ka pritur shumë mirë, gjithashtu kemi dhe një tifozeri shumë të mirë, që do të thotë që deri më tani është gjithçka në rregull. Për ndeshjen ndaj Bellasicës, nuk kam shumë për të thënë, për shkak se duhet të luajmë si një grup, duhet të jemi të gjithë së bashku, njëri tjetrin ta ndihmojmë,

LIGA E PARË - JAVA EVII

# SHKUPI MYSAFIRE E BELLASICËS, SHKËNDIJA PRET POBEDËN



që në fund të fitojmë për ekipin”, ka deklaruar Armel Bradji. Edhe këtë ndeshje Shkupi do të jetë me dy mungesa, shkak i lëndimit vazhdon të jetë jashtë ekipit Besart Krivanjeva, ndërsa Rron Broja me shumë gjasa do të mungojë edhe ndaj Bellasicës, pas lëndimit që pësoi në nyjën e këmbës. Nga ana tjetër skuadra kampione Shkën-

dija kërkon që të vazhdon ecurinë pozitive në kampionat dhe ndaj Povedës do të lufton për tre pikë e reja. Mesfushori i kuqezinjve Enur Totre pret që nga kjo përballje të dalin fitues dhe të marrin rezultatin e duhur. “Na pret një ndeshje e vështirë përballë një kundërshtari me të cilët asnjëherë nuk e kemi patur lehtë, mirëpo besoj se në do

të japim më të mirë do të bëjmë maksimumin për ta fituar ndeshjen dhe pikët të ngelin në Tetovë. Sigurisht që duhet ta shfrytëzojmë momentin e mirë që jemi, luajmë mirë dhe po radhisim fitore njëra pas tjetres. Kemi gjashtë ndeshje të fituara rresht 4 në kampionat dhe 2 në kupë dhe sigurisht duam të vazhdojmë me këtë rritëm.

## TAKIMET E JAVËS SË SHTATË

A. PANDEV - RENOVA	15:30
BELASICA - SHKUPI	15:30
SHKËNDIJA - POBEDA	15:30
VARDARI - SILEKSI	15:30
MAK. GJ.P - RABOTNIÇKI	15:30

Duke ditur vështirësitë që na ka bërë skuadra e Povedës sezonin e kaluar jemi të gatshëm për të qenë maksimalisht të koncentruar për të bërë më të mirën dhe për të fituar ndeshjen dhe për të mos lejuar befasi”, tha për gazetën Koha, Enur Totre. Në takimet tjera befasia e këtij sezoni dhe lideri aktual në tabelë, Akademija Pandev pas fitores së thellë në terren mysafirë ndaj Povedës (4:2), në takimin e sotshëm (e mërkurë) do të jetë nikoqire e skuadrës së Renovës. Ekipi i Akademija Pandev në këtë përballje do të futet pas fitores së tretë me radhë dy në kampionat dhe 1 në kupë, ndërsa pret që edhe ndaj ekipit nga Xhepçishiti të shënon fitoren e radhës. Ekipi i Vardarit do të pret në terren vendas Sileksin ndërsa Makedonija GJ.P do të luajë para publikut vendas me Rabotniçkin. Të gjitha takimet do të fillojnë në ora 15:30.

## Kastrati lë Kroacinë dhe Shqipërinë për Kosovën

Lojtari i talentuar i Lokomotivës së Zagrebit që para një jave realizojë tripletë, ka vendosur se fanellën e cilës kombëtare do të veshë. Lirim Kastrati është diskutuar shumë në media kohët e fundit, pasi përveç Shqipërisë pati një ofertë nga kombëtarja kroate. Federata e Futbollit të Kosovës konfirmon se Kastrati do të ftohet nga trajneri i Kosovës, Bernard Challandes për ndeshjen kundër Maltës dhe Ishujve Faroe që do të luhen në tetor. Lajmi është konfirmuar nga “insporti” nëpërmjet një komunikimin me përgjegjës për media pranë FFK-së, Bajram Shala. Ndërsa vetë lojtari në një intervistë për “Sporti në KTV” e ka pranuar



se nuk do të braktisë vendin e tij: “Para disa ditësh, më ka telefonuar trajneri i Kosovës, Challandes, me të cilin kemi biseduar dhe më ka thënë se do të më ftojë për dy nde-

shjet e muajit tetor. Unë jam shumë i lumtur që do të kem rastin të luaj me Kosovën A dhe mezi po pres që të bashkohem me skuadrën”. Më pas 19 vjeçari ka sqaruar

keqkuptimin që është bërë nga media rreth mundësisë së zgjedhjes së ekipit kroat: “Nuk e kam thënë në asnjë media se do ta lë Kosovën për Kroacinë. Intervista ime u keqkuptua. Unë kam thënë nëse Kosova dhe Shqipëria nuk do të më ftonin, atëherë unë do të zgjidhja Kroacinë. Por nuk e lë Kosovën për asnjë Kombëtare tjetër, pasi vendimin e kam marrë përpara disa viteve”, është shprehur Kastrati. Sulmuesi ka bërë një paraqitje fantastike me Lokomotivën e Zagrebit në këtë fillim sezoni teksa në 7 ndeshje ka shënuar 5 gola, nga të cilat 3 në ndeshjen ndaj Slaven Belupo në Superligën e Kroacisë.



## De Biasi me kombëtare të re

Gianni de Biasi është shumë pranë nënshkrimit të kontratës për t'u ulur në stolin e një tjetër kombëtareje. Trajneri italian me pashaportë shqiptare ka udhëtuar drejt Armenisë, për të biseduar me presidentin e sapozgjedhur të federatës armene të futbollit Artur Vanetsyan, pasi ai mendon se De Biasi është i duhuri duke qenë se e njeh mirë fazën eliminatore. Mediat armene konfirmojnë se palët nuk kanë arritur ende një marrëveshje për shkak të çështjeve financiare. Ekziston edhe një mundësi e dytë pasi është folur edhe me ish-sulmuesin francez Youri Djorkaeff, por ai nuk ka liçencë. Në mediat vendase theksohet eksperiencia e trajnerit me ekipin kombëtar shqiptar dhe pjesëmarrja në Euro 2016.

## Kosova pa medalje në Botërorin e xhudos

Kosova ka mbetur pa medalje në Botërorin e xhudos, që po mbahet në Baku të Azerbajxhanit. Shpresa e fundit e ekipit kosovare ishte Loriana Kuka, por xhudistja u mposht në meçin e saj të parë. Ajo humbi nga sllovenia Klara Apotekar. Ditë më parë, nga ky kampionat u eliminuan edhe dy xhudistet tjera Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova, ndërsa pa medalje mbeti edhe xhudisti Akil Gjakova.





REPUBLIKA E MAQEDONISË  
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nën-punësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të Punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

### SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 188/2018

për punësimin e 1 nëpunës publik nga grupi I, nëngrupi II në „Institucionin Publik Qendra Ndërkomunale e Punës Sociale - Strumicë” për vendet e punës në vijim:

1. SO30102G007 Arkivist IV - Ndihmës profesional i nivelit IV, Njësia për punë administrative dhe menaxhim me burime njerëzore 1 realizues(ë)

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VA ose niveli i kualifikimeve IV, sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm profesional.
- me ose pa përvojë pune

#### Kompetencat e përgjithshme:

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

#### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

#### Orari i punës :

- Ditët e punës E hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
- Rroga neto: 12.629,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1. Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës. Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë. Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësve administrativë.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar. Faza e 2 – të: provimi i nëpunësve administrativë realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inicohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës. Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Në bazë të nenit 148 dhe nenit 149 nga Ligji për sigurim shëndetësor (Gaz. zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), neni 13 nga Rregullorja për specializimet dhe subspecializimet të punëtorëve shëndetësorë dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë me arsimim të lartë nga fusha e medicinës (Gaz. zyrtare e RM nr. 85/15) dhe Programit për nevojat e kadrore specialiste dhe subspecialiste në pajtim me rrejtin e institucioneve shëndetësore (2015-2018) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 69/15, 96/15, 208/15, 229/15, 183/16 dhe 172/18), Fakulteti i mjekësisë pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup shpall:

### Shpallje publike për paraqitje të kandidatëve për regjistrim gjegjësisht lejim të specializimit dhe subspecializimit të punëtorëve shëndetësor me arsim sipëror nga sfera e medicinës për vitin 2018

Nr. rend.	Specializim	Për të punësuar shëndetësor gjegjësisht bashkëpunëtor shëndetësor në Institucionet publike shëndetësore
1	Kirurgjia abdominale	3
2	Anesteziologjia dhe medicina intensive	20
3	Pediatria spitalore	13
4	Pediatria jashtëspitalore	5
5	Gastroenteropatologjia	1
6	Gjinekologjia dhe obstetrika	13
7	Dermatovenereologjia	3
8	Kirurgjia për fëmijë	3
9	Epidemiologjia	4
10	Endokrinologjia	4
11	Medicina interne	12
12	Infektologjia	6
13	Kardiologjia	3
14	Medicina e punës	4
15	Biokimia medicinale	10
16	Mikrobiologjia medicinale me parazitologji	7
17	Neurologjia	10
18	Neurokirurgjia	2
19	Nefrologjia	3
20	Medicina nukleare	3
21	Kirurgjia e përgjithshme	7
22	Onkologjia dhe radioterapia	2
23	Ortopedia	7
24	Oftalmologjia	3
25	Patologjia	2
26	Psikiatria	6
27	Pulmologjia me alergologji	2
28	Radiologjia	11
29	Reumatologjia	1
30	Medicina sociale dhe shëndeti publik	5
31	Medicina sportive	3
32	Medicina e transfuzionit	4
33	Traumologjia	1
34	Medicina urgjente	8
35	Kirurgjia urologjike	4
36	Medicina fizikale dhe e rehabilitimit	3
37	Higjiena dhe ekologjia shëndetësore	14
38	Hematologjia	4
39	Psikiatria medicinale	2
40	Gjenetika medicinale	2
41	Fizika nukleare medicinale	3

Kërkesa për miratim të specializimeve/subspecializimeve së bashku me dokumentacionin e kompletuar dorëzohet nga ana e Institucionit publik shëndetësor në të cilin është i punësuar punonjësi shëndetësor, gjegjësisht bashkëpunëtori shëndetësor, në pajtim me dispozitat nga Ligji për mbrojtje shëndetësore dhe Rregullorja për specializimet dhe subspecializimet të punëtorëve shëndetësorë dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor me arsim sipëror më së voni në afat prej 30 ditëve nga dita e publikimit të Shpalljes, deri në arkivin e Fakultetit të mjekësisë pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, nr. “50-ta Divizija” nr. 6, 1000 Shkup.

Ligji për mbrojtje shëndetësore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16) dhe Rregullorja për specializimet dhe subspecializimet të punëtorëve shëndetësorë dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor me arsim sipëror nga sfera e medicinës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 85/15) mund të gjenden në ueb faqen e Fakultetit të mjekësisë [www.medf.ukim.edu.mk](http://www.medf.ukim.edu.mk).

UNIVERSITETI “SHËN KIRILI DHE METODI”  
FAKULTETI I MJEKËSISË – SHKUP



IPSH QENDRA E SHËNDETIT PUBLIK  
0204 nr. 479/1  
25.09.2018  
VELES

Në bazë të nenit 156, nenit 157 paragrafi 1 alineja 1, nenit 158 dhe nenit 159 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/2012, 145/2012, 87/2013, 164/2013, 39/2014, 43/2014, 132/2014, 188/2014, 10/2015, 61/2015, 154/2015, 192/2015, 17/2016 dhe 37/2016), në bazë të Pëlqimit nr. 18-2858/2 të datës 28.03.2018 të Ministrisë së Financave të Republikës së Maqedonisë, nenit 30 paragrafi 2 të Statutit të IPSH Qendra e Shëndetit publik – Veles, si dhe në bazë të Vendimit për punësim nr. 0204- 478/1 të datës 25.09.2018 të u.d Drejtorit i Qendrës, IPSH Qendra e shëndetit publik – Veles publikon

### SHPLLJE PUBLIKE

Për punësim të 5 (pesë) doktorëve të medicinës për kohë të pacaktuar

1. IPSH Qendra e shëndetit publik – Veles ka nevojë për punësim të:

**5 (PESË) DOKTORËVE TË MEDICINËS PËR KOHË TË PACAKTUAR**

Edhe atë.

- Për nevojat e IPSH “Qendra e shëndetit publik” Veles në Veles – **DOKTOR TË MEDICINËS – 1 (NJË) REALIZUES, (PËR SPECIALIZIM PËR MEDICINË SOCIALE ME ORGANIZIM TË VEPRIMTARISË SHËNDETËSORE).**

- Për nevojat e IPSH “Qendra e shëndetit publik” Veles në “Njësine rajonale Kavadar” në Kavadar – **DOKTOR TË MEDICINËS – 1 (NJË) REALIZUES, (PËR SPECIALIZIM PËR HIGJENË ME EKOLOGJI SHËNDETËSORE).**

- Për nevojat e IPSH “Qendra e shëndetit publik” Veles në “Njësine rajonale Negotinë” në Negotinë – **DOKTOR TË MEDICINËS – 1 (NJË) REALIZUES, (PËR SPECIALIZIM PËR HIGJENË ME EKOLOGJI SHËNDETËSORE).**

- Për nevojat e IPSH “Qendra e shëndetit publik” Veles në “Njësine rajonale Gjevgjeli” në Gjevgjeli – **DOKTOR TË MEDICINËS – 2 (DY) REALIZUES, (PËR SPECIALIZIM PËR MIKROBIOLOGJI MEDICINALE ME PARAZITOLOGJI DHE PËR HIGJENË ME EKOLOGJI SHËNDETËSORE).**

2. Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore;
- Të mos i shqiptohet ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

Kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Të kenë të mbaruar arsimin sipëror me së paku 240 kredi të arritura sipas SETK, ose shkallë të VII/1 të arsimit – Fakulteti i medicinës;

- Provim të dhënë profesional;

- Të posedojnë licencë për punë;

- Me ose pa përvojë pune;

3. Orari javor i punës është 40 (dyzet) orë. Neto pagesa fillestare për Doktor i medicinës është 25.968, 00 denarë.

4. Të bashkëngjitur me fletëparaqitjen, kandidatët obligohen të parashtrijnë dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt (emri dhe mbiemri, adresa e banimit ose qëndrimi, telefoni dhe e-mail adresa);

- Biografi e shkurtër (CV);

- Certifikatë të shtetësisë - origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- Certifikatë të mjekut, jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës - origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- Diplomë me sukses mesatar;

- Dëshmi për njohje të gjuhës së huaj (angleze, frënge ose gjermane);

- Certifikatë për Fakultet të mbaruar të medicinës – origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- Certifikatë për provim të dhënë profesional – origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- Licencë për punë – origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- Kandidatët duhet të theksojnë se për cilën Njësine rajonale paraqiten.

5. Afati për paraqitje është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

6. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i tërësishëm dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e Komisionit për përzgjedhje të kandidatëve.

7. Pas përzgjedhjes së realizuar të kandidatëve të paraqitur për doktor të medicinës, të cilët i përmbushin kushtet në pajtim me Shpalljen publike, do të realizohet provim kualifikues, në pajtim me nenin 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/2012, 145/2012, 87/2013, 164/2013, 39/2014, 43/2014, 132/2014, 188/2014, 10/2015, 61/2015, 154/2015, 192/2015, 17/2016 и 37/2016).

8. Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter) të parashtrihen përmes postës ose në Arkivin e IPSH Qendra e shëndetit publik – Veles, rr. “Llazo Osmakov” nr. 14, 1400 Veles, Republika e Maqedonisë, ndërsa me shenjë “PËR SHPLLJE PUBLIKE PËR PUNËSIM”.

IPSH QENDRA E SHËNDETIT PUBLIK – VELES

Në bazë të nenit 89-a të Ligjit për arsim të mesëm, („Gazeta Zyrtare e RM” nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 06/12, 100/12 , 24/13 41/14.....64/18), ndërsa në pajtim me nenin 90 të Statutit të SHMBP “Gjorçe Petrov” Kavadar, Vendimit nga Kryetari i komunës për publikimin e shpalljes për zgjedhje të drejtorit dhe Vendimit të këshillit të shkollës nr. 02-542/3 të datës 20.09.2018, Këshilli i shkollës pranë SHMBP “Gjorçe Petrov” Kavadar publikon:

### SHPLLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të shkollës

Kandidati i cili do të paraqitet në bazë të shpalljes publike duhet të përmbushë kushtet formale në vijim:

- Të ketë të mbaruar arsimin sipëror dhe të përmbushë kushtet për mësimdhënës, pedagog ose psikolog në shkollë të mesme;
- Të ketë së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në institucion për punë edukativo-arsimore të verifikuar nga MASH;
- Të ketë të dhënë provimin për drejtor;
- Të jetë shtetas i R. Maqedonisë;
- Të ketë shëndet psikofizik dhe i aftë për punë;
- në momentin e zgjedhjes të mos i jetë shqiptuar vendim i plotfuqishëm gjyqësor ose dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- të kenë certifikatë përkatëse jo më të vjetër se pesë vjet për njohje të gjuhës angleze TOEFEL IBT – së paku 30 pikë, IELTS – së paku 3 pikë, BULATS – së paku 20 pikë ose KET (Cambridge English) – të dhënë ose APTIS së paku niveli B2

Kandidatët për drejtor duhet të parashtrijnë dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me biografi profesionale (CV) dhe letër motivimi
- Diplomë për arsim sipëror të mbaruar;
- Vërtetim për përvojën e punës në institucion për punë edukativo-arsimore;
- Certifikatë për provim të dhënë për drejtor;
- Certifikatë të shtetësisë jo më të vjetër se 6 muaj
- Program për punë për periudhë prej 4 vjet
- Certifikatë të mjekut
- Vërtetim se nuk është i dënuar dhe se kundër tij nuk ka procedurë penale
- Vërtetim se nuk ka ndalesë gjyqësore për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë jo më të vjetër se pesë vjet për njohje të gjuhës angleze (të definuar me këtë shpallje)

Neto pagesa fillestare parashihet në pajtim me matjet dhe kriteret e përcaktuara në Marrëveshjen kolektive për arsim të mesëm dhe është 27.322,00 denarë.

Orari i punës për drejtor është prej ora 07:00 deri në ora 15.00, dhe ajo në kuadër të 40 orëve të punës në javë prej ditës së hënë deri ditën e premte.

Dokumentet (në original ose kopje të vërtetuar) në zarf të mbyllur mund të parashtrihen personalisht në arkiv ose përmes postës në adresën “Shishka” nr. 23 1430 Kavadar me shenjë për “Këshillin e shkollës Komisioni për zgjedhje të drejtorit”. Afati për parashtrimin e dokumenteve është tetë /8/ ditë duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes. Intervista do të realizohet me kandidatët të cilët i përmbushin kushtet formale për çka do të informohen enkas. Zgjedhja do të realizohet brenda afatit ligjor. Dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara do të refuzohen dhe nuk do të shqyrtohen.

Këshilli i shkollës pranë SHMBP “Gjorçe Petrov” Kavadar  
Kryetar  
Luçço Binov



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

### Njoftim

Qendra për biznes dhe inovacion e Universiteti i Evropës Juglindore shpall njoftim publik për grumbullim të ofertave për sa vijon:

Grumbullim të ofertave për dhënie me qira të hapësirës për market (shitore) në kampusin e UEJL-së.

Të gjithë të interesuarit mund të marrin informata më të hollësishe në:

[www.seeu.edu.mk/sq/information/tenders](http://www.seeu.edu.mk/sq/information/tenders)

**Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093**

# LIDER TË PLOTË: SEZONI I RI I LIVERPOOL, JUVE, PSG DHE BAYERN NIS ME O HUMBJE

Liderët e secilës prej 4 ligat më të mëdha Europiane kanë fituar të gjitha ndeshjet e luajtura dhe në Gjermani, Francë dhe Itali, respektivisht Bayern Munich, Paris Saint-Germain dhe Juventus vijojnë dominimin. Përjashtim bën Liverpool. Skuadra e Jurgen Klopp qëndron në krye të Premier Leagues, edhe pse "të kuqtë" nuk e kanë fituar këtë titull që nga viti 1992



Në katër ligat më të mëdha Europiane, nuk ka shumë surpriza në krye të tabelës. Liderët e secilës prej kompeticioneve kanë fituar të gjitha ndeshjet e luajtura dhe në Gjermani, Francë dhe Itali, respektivisht Bayern Munich, Paris Saint-Germain dhe Juventus vijojnë dominimin. Përjashtim bën Liverpool. Skuadra e Jurgen Klopp qëndron në krye të Premier Leagues, edhe pse "të kuqtë" nuk e kanë fituar këtë titull që nga viti 1992. Ata kanë pasur një sezon të mirë duke marrë kështu edhe pikët maksimale. Ndeshjet e radhës në Angli do të jenë vendimtare, me

Manchester City-n dhe Chelsea-n që qëndrojnë të dytët, me vetëm 2 pikë diferencë nga "kampionët" e përkohshëm. Mohamed Salah me shokë do të kenë një përballje "kokë më kokë" me "Blutë e Londrës", më pas do të bëjnë një vizitë në stadiumin "San Paolo" ku do të luajnë kundër Napolit të Elseid Hysajit. Nëse në Angli ka një konkurrencë shumë të fortë, nuk ndodh e njëjta gjë në Francë. PSG i Thomas Tuchel qëndron i pashqetësuar në krye të tabelës me 5 pikë larg nga vendi i dytë. Kjo është hera e parë në historinë e klubit francez që kanë fituar 6 ndeshjet e para të

Ligës. Ato kanë vendosur një rekord në shtëpi, e ndërsa në Europë e nisën me humbje në "Anfield". E njëjta panoramë paraqitet në Gjermani dhe Itali, ku si Bayern ashtu edhe Juve janë në kërkim të titullit të shtatë dhe të tetë respektivisht. Niko Kovac ka sjellë një ndryshim në skuadër. Ekipi i tij është i vetmi që ka arritur të fitojë katër ndeshje radhazi në Bundesligë, teksa qëndron dy pikë larg Hertha Berlin dhe katër pikë nga Borussia Dortmund dhe Werder Bremen. Nëshkrimi i Cristiano Ronaldos ka thëlluar hendekun me "Zonjës së Vjetër" dhe ekipeve

të tjera të Seria A. Massimiliano Allegri ka fituar 5 ndeshjet e para me një Ronaldo që ka qenë vendimtar në 2 takimet e fundit, kundër Sassuolo dhe Frosinone. Surprizë nuk ka as në La Liga, por ndryshe nga 4 ekipet e sipërpërmendura, Barcelona dhe Real Madrid, rivalët e drejtpërdrejtë ndajnë mes njëri tjetrit kreun klasifikimit me nga 13 pikë secila; në 5 ndeshje të luajtura numërojnë 4 fitore dhe një barazim. Të tretët qëndrojnë Alaves, e ndërsa Atletico Madrid nuk ka pasur një sezon shumë të mirë me dy barazime, dy fitore dhe 1 humbje.



## Eto'o kritikon Neymar: Të punojë aq fort, sa Cavani dhe Mbappe

PSG mund të jetë një ekip shumë i suksesshëm, nëse Neymar fillon të punojë aq fort, sa Edinson Cavani dhe Kylian Mbappe. I këtij mendimi është Samuel Eto'o. "Aureola" e brazilianit u gjend "nën zjarrin" e kritikave pas humbjes 3-1 të PSG në Ligën e Kampionëve, kundër Liverpool, javën e shkuar. Megjithatë i ndihmoi të tijtë të rehabilitohen në fundjavë, në një sukses 3-1 kundër Rennes, Eto'o ka rezerva për yllin brazilian. Kamerunasi i njohur ka thënë që, nëse PSG do të arrijë potencialin e plotë, kërkohet më shumë nga braziliani 26-vjeçar. Dhe si tri herë fitues i Ligës së Kampionëve, dy herë me Barcelonën dhe një herë me Interin, Eto'o është i kualifikuar për të folur mbi këtë temë. "Ne duam ta shohim Neymar duke vrapuar pas mbrojtësve, për ta ndihmuar ekipin e tij, - tha Eto'o për "Canal +". - Cavani e bën këtë, por nuk mjafton vetëm një lojtar. Mbappe, gjithashtu, e bën këtë, por figura kryesore është Neymar. Nëse ai e bën këtë gjë, e gjithë skuadra do të kthehet dhe do të ndihmojë në fazën difensive. PSG duhet të luajë si ekip. Nëse të gjithë mbrojnë, atëherë do të ketë çdo mundësi për të fituar. Franca e fitoi Kupën e Botës vetëm sepse mbrohej mirë". Në total, Neymar ka luajtur 37 herë për PSG dhe ka shënuar 32 gola, duke asistuar në 19 gola të tjera për shokët e skuadrës.

## Roma "vullkan", tani edhe Dzeko nën akuzë

Nga presidenti Pallotta tek drejtori sportiv Monchi, për të vazhduar me trajnerin Di Francesco: të gjithë janë nën akuzë te Roma, për një start sezonal mjaft zhgënjyes. Tashmë tifozët po u kthehen edhe lojtarëve dhe të hënën në shënjestër përfundoi Steven Nzonzi, mesfushori i blerë me bujë këtë verë. Kampioni i botës postoi në Twitter një mesazh për të reklamuar faqen e tij në Snapchat dhe gjeti momentin më të keq të mundshëm, sepse drejt tij vërshuan ofendimet. Një ditë pas Nzonzi-t e ka pasur radhën Edin



Dzeko, sulmuesi boshnjak që ka vite që është idhull në Romë, për shkak të besnikërisë ndaj klubit dhe rendimentit konstant në fu-

shë. Megjithatë, tërbimi i tifozëve nuk lidhet me paraqitjet në fushë, por me një veprim të Dzeko-s, i cili ndryshe nga shokët e skuadrës, që

përfunduan në grumbullim të detyruar si ndëshkim për humbjen në Bologna, udhëtoi për në Milano për të marrë pjesë në Javën e Modës, i ftuar nga Dolce & Gabbana. Në fakt Dzeko e kishte programuar me kohë udhëtimin në Milano, me aprovimin e klubit, ndërsa u nis sapo mbaroi ndeshja në Bologna dhe vetëm më vonë u njoftua për grumbullimin e skuadrës, por pak rëndësi ka për tifozët, që e kanë kritikuar ashpër në rrjetet sociale dhe ndoshta në ndeshjen e mesjavës kundër Frosinone-s do ta kontestojnë ashpër.

## Pogba do të rikthehet te Juventus

Paul Pogba, mesfushori francez i Manchester United, mund të kthehet në Seria A sezonin e ardhshëm, te kampionët italianë, ku ka luajtur dy sezone më parë. Këtë e konfirmon sot, në ballinën e saj, gazeta "Tuttosport". Sipas edicionit të së martës, kampioni i botës do ta kishte të lehtë për të zgjedhur fatin e tij, duke u rikthyer te Juventus. Mesfushori ka qenë edhe në "radarin" e Barcelonës, por

informacioni i mbledhur nga gazeta torineze, shumë pranë bardhezinjve, është se francezi "do vetëm Juve". Marrëdhëniet mes Pogba dhe Jose Mourinhos vazhdojnë të jenë temë debati çdo ditë në mediat angleze, por jo vetëm, me trajnerin portugez që është munduar të mohojë gjithçka në këtë drejtim. Sidoqoftë, "shigjetat" mes njëri-tjetrit nuk kanë munguar. Së fundi ishte futbollisti fran-

cez, që e kritikoi trajnerin e tij për qasjen mbrojtëse në përballjen në Premier League, kundër Wolverhampton, në "Old Trafford". Këto situata, sipas "Tuttosport", tregojnë se Pogba po ecën drejt Torinos. Çka do të ishte një rikthim për të, në një mjedis ku shkëlqeu dhe u bë transferimi më i shtrenjtë në historinë e futbollit, para se Neymar të bënte të njëjtin veprim në aksin Barcelonë-PSG.



## FONDE EVROPIANE PËR MAQEDONINË EVROPIANE



[www.izleziza.mk](http://www.izleziza.mk)

- Ndhimja totale vjetore e BE-së për Maqedoninë është 90 milion euro, respektivisht 260.000 euro në ditë.
- Hyjmë në Union prej 500 milion konsumatorëve ose treg 250 herë më të madh se tregu vendor.
- 15.5 milion euro vjetore për Maqedoninë nëpërmjet Programës së BE-së për transport (fonde me të cilat ndërtohen rrugë, ura, hekurudha, tunele dhe infrastrukturë tjetër).
- 8.5 milion euro mjete evropiane për mbrojtjen e kufijve të Maqedonisë për vitin 2018.
- 15 milion euro mjete evropiane për bujqit në Maqedoni për vitin 2019.
- 18 milion euro në vitin 2020 për reformat në gjyqësor dhe policinë e Maqedonisë.

[www.izleziza.mk](http://www.izleziza.mk)

**DASHI** 21. mars - 20. prill  
 Duhet të tregoni më shumë kujdes ndaj vetes dhe shëndetit tuaj, sidomos nëse keni ndërmarrë një rrugëtim të ri profesional, dinamik dhe lodhës. Duhet të tregoni më shumë kujdes për lidhjet tuaja, pasi shumë shpërqendrim, mund të minojnë një raport të mirë dhe të konsoliduar.

**DEMI** 21. prill - 21. maj  
 Në këtë moment është e rëndësishme që të lidhni më shumë aleanca, të cilat do ju lejojnë që të merrni më shumë rezultate nga pikëpamja profesionale. Këshillohet që të tregoni kujdes dhe të mos ndikoheni nga bindjet që keni krijuar në të kaluarën.

**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor  
 Do të rigjeni gëzimin dhe gjallërinë e cila do ju lejojë që të mbyllni gjithë ato raporte aspak të frytshme, si nga pikëpamja sentimentale edhe profesionale. Projekte të reja do ju dhurojnë kënaqësi të madhe.

**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik  
 Do të jeni shumë kokëfortë, por kjo gjë do ju lejojë që të arrini objektiva të mëdha, në vendin tuaj të punës. Një kompromis i mirë, mund të lejojë që të arrini një marrëveshje të mirë brenda çiftit.

**LUANI** 23. korrik - 22. gusht  
 Kjo e martë, do të jetë një ditë e rëndësishme për gjithë ata projekte që keni përpunuar gjatë muajve të fundit. Duhet të jeni shumë të vendosur, në mënyrë që të jeni me këmbë në tokë. Në dashuri duhet të jeni shumë kurajoz dhe të shprehni hapur ndjenjat tuaja.

**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator  
 Parashikohet një ditë e qetë dhe relaksuese, e cila do ju lejojë që të përkufizoni mirë disa angazhime që keni, për shkak të lodhjes nga rutina. Do të arrini të mbyllni një marrëveshje me leverdi. Bëni kujdes me shpenzimet.

**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor  
 Do të keni mundësi të ideoni një projekt të ri, i cili do të rezultojë mjaft i frytshëm. Do të dini të jeni të lirshëm dhe kjo gjë do të jetë sekret i suksesit tuaj. Megjithatë në dashuri, këshillohet që të jeni më të vendosur dhe të largoni ndrojtjen.

**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor  
 Parashikohen ngadalësimet të vogla, të cilat gjithsesi nuk duhet t'iu dekurajojnë, për shkak se intuita juaj do ju lejojë që të mbyllni në kohë një projekt që keni nisur. Këshillohet që të jeni shumë strategjik, lidhur me investimet.

**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor  
 Ju pret një javë e madhe suksesi, e cila do ju gjejë të realizuar në sferën profesionale. Sigurisht ka disa gjëra të pasigurta, të cilat ju vendosin nën presion, ndaj mos u dekurajoni. Megjithatë mund të mbështeteni tek mbështetja e vlefshme e bashkëpunëtorëve tuaj. Në mbrëmje, parashikohen takime mjaft të frytshme.

**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar  
 Mos hezitoni të kërkon këshilla nga një kolegu juaj më ekspert lidhur me investimet, pasi tashmë nuk ju lejohet që të gaboni. Një projekt i juaji ka të gjitha mundësitë për t'iu dhuruar kënaqësi të mëdha. Në mbrëmje, mundohuni të kaloni më shumë kohë me familjen ose partnerin/en. Përgjithësisht, parashikohet një mbrëmje e cila do ju gjejë më romantik.

**UJORI** 21. janar - 19. shkurt  
 Parashikohet një ditë, e cila do ju lejojë që të përqendroheni më mirë në punën tuaj dhe në perspektivat e së ardhmes. Duhet të jeni shumë të kujdesshëm dhe përqendruar në zgjidhjen e të papriturave të vogla, që kanë të bëjnë me realizimin e investimeve të reja. Në dashuri do të jeni në kërkim të stimujve të rinj.

**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars  
 Duhet të jeni shumë të kujdesshëm me fjalët, pasi në mënyrë të pavullneshme, mund të dëmtoni një person që keni përzemër. Këshillohet që të shmangni ushqyerjen e debateve të kota. Duhet të reflektoni më shumë dhe të mos përfshihen në projekte shumë të rrezikshme nga pikëpamja ekonomike.

<b>Mensur Mamuti</b>	KËNGË SOLEMNE E SHITIT HULLUMTUESI ANGLEZ NË FOTO	<b>H</b>	QYTETI I LINDJES SE HULLUMTUESIT NË FOTO	KRYENEÇESIA	KËNGËTARJA SHQIPTARE, CAMI
DOBI					
DIZAJNERI ITALIAN I MODES, XHORXHO					
<b>A</b>					
ISH PRESIDENTI EGJIPTAS, EL SADAT					
AZOTI		FILM I SPILBERGUT (E.T.) ANTIMATERIE, ANTITERRMUE			
SHUMICË SENDESH, DUKURISH APO QENIESH					
"INTERNATIONAL"				METRI LYHEM ME PUDËR	
SHENJA PËR NDALIM					GUR GËLQEROR, ÇMËRS
NDONJËRI, NDOKUSH					
RENIUMI			DRITA PELINGU DRITA HAXHIRAJ		QYTETI NË MALI
NOFKA E HULLUMTUESIT NË FOTO (KUÇEDRA, SPANJ)					ENERGJIA
KUMBIMI, USHTIMA					<b>KOHA</b>
KILOMETRI		SULFURI EMRI I VJETËR I TAJLAND	<b>S</b>	QYTET DHE LUMË NE KOLORADO NJË DINASTI KINEZE	GRADA DETARE E HULLUMTUESIT NË FOTO
<b>KOHA</b>	MESAZH TELEFONIK, SMS KLUP GREK				PESHK I UJËRAVE TË EMBLA
ATA QË MERRËN ME ANIMIZEM					KLUBI I KARATESË NDRE MJEDA
SHKRONJË GREKE					SHEGË QYTEZË NË SUEDI
KALUMI		LUNDRUESI I PARË RRETH TOKES, FERDINAND, PERS. NË FOTO ËSHTË NJËRI I DYTË QË Ë KALOI RRUZULLIN			
				NORVEGJIA AUSTRIA	
					KALIFI I DYTË ISLAM SPANJA
					INTERNET PROTOCOL KËNGËTARJA QAZIMI



ZGJIDHJET: H, FITIM, ARMANI, ANVAR, N, ITI, SASIA, INT, M, STOP, DIKUSH, RE, DP, EL DRAKE, KK, JEHONA, NAR, KM, S, JAMPA, ES EM ES, IP, ANIMISTET, ETA, N, OMER, K, MAGELANI.

**Shumë i lehtë** **Sudoku** **mesatar**

5		4		7		8		1	9								7
	8							7		1	6			8			2
		9	5			4				2							
					8	1							2				
2			1		4			8				4	6	1			7
		1	7							8						6	3
		6			1	2			5								9
	5							9	3								1
9		8		5		3		7			1	5				8	

Shumë i lehtë: 524679831, 683412579, 719583426, 497368152, 235194768, 861725943, 376941285, 152837694, 948256317. Mesatar: 945216387, 716358942, 823749165, 657823419, 239461578, 184975623, 568137294, 392684751, 471592836.

## HITLERI dhe LENINI luftojnë për postin e kryetarit

Në qytetin e vogël peruan Yungar, lart në Ande, brenda dy javësh do të javësh do të mbahen zgjedhjet në të cilat Hitleri shpreson të kthehet në pushtet, ndërsa Lenini përpiqet ta pengojë. Reuters njofton se kudo nëpër qytet janë vënë mbishkrimet "Hitler po kthehet" dhe "Hitleri është me popullin". Mbishkrimet kanë të bëjnë me ish-prefektin e qytetit Hitler Alba Sanchez i cili në pushtet ka qenë nga vitit 2011 deri në vitin 2014, transmeton Koha.net.

Rivali i tij politik Lenin Vladimir Rodrigues Valverde javën e shkuar u përpoq ta pengonte kandidimin e Hitlerit për zgjedhjet që mbahen më 7 tetor, por komisioni lokal e hodhi poshtë kërkesën e tij. Hitler Alba thekson se kundërsh-ton të gjitha ato për të cilat ishte angazhuar Adolf Hitleri dhe se dëshiron të qeverisë në mënyrë të ndershme e transparente. Alba ka pohuar se babai i tij s'e



ka ditur kush ka qenë Hitleri kur ia kish-te vënë emrin. Ai ka shtuar se kishte menduar ta ndërronte emrin kur kishte kuptuar kush kishte qenë Hitleri, porse megjithatë kishte hequr dorë. "Unë jam Hitleri i mirë", ka thënë Alba për televizio-

nin peruan RPP. Reuters thekson se në Peru dhe në vende të tjera të Amerikës Latine, prindërit shpesh zgjedhin emra të huajsh që tingëllojnë çuditshëm përkundër asaj se ata emra jashtë mund të kenë konotacion negativ.

## Krenarë me Merkelin dhe Mercedesin

Kur bëhet fjalë për personalitetet historike, gjermanët janë krenarë me politikanët e tyre - kështu ndodh edhe me kancelaren e tanishme Angela Merkel, e cila gëzon popullaritetin më të madh mes gjermanëve, shkruan konservatorja gjermane WELT AM SONNTAG. Anketa është kryer në fund të korrikut 2018 dhe pjesë e saj kanë qenë 1047 persona. Atyre u është kërkuar të përzgjedhin tre personaliteteve nga fusha të ndryshme (politikë, shkencë, sport dhe kulturë), të cilët në të kaluarën i kanë bërë krenarë.

Në krye të ranglistës është Angela Merkel, ku është përmendur nga 16 për qind e të gjithë anketuarve. Menjëherë pas saj, ndodhet politikani i majtë Helmut Schmidt (SPD) me 11 për qind, ndërsa më pas ndodhen Willy Brandt (SPD) dhe Helmut Kohl (CDU), secili me 6 për qind. Të gjithë përveç Merkelit, kanë ndërruar jetë. Lista ndiqet me



Frank-Walter Steinmeier pesë për qind dhe Konrad Adenauer (CDU) me katër për qind, përcjell albinfo.ch. 49 për qind e të pyeturve kanë përmendur politikanë në përzgjedhjen e tyre. Si sportist më i vlerësuar në anketë shfaqet Joachim Löw me tre për qind, kurse si shkrimtar dhe shkencëtar shfaqet Johann Wolfgang von Goethe dhe Al-

bert Einstein, secili me dy për qind. Në pyetjen se cili qytet i bën më krenarë gjermanët, vendin e parë e zë Berlini, ndërsa më pas Mynihu. E njëjta pyetje është parashtruar për firmat, ku dominojnë fabrikat e automobilave. Mercedes ndodhet në vendin e parë me 17 për qind, ndjekur nga Volkswagen (16 për qind) dhe BMW (11).



Për shumëkënd mund të tingëllojë çuditshëm por një person jeton me 5 gra. Të kesh 5 gra ndoshta nuk është një gjë që mund ta shohësh çdo ditë, por Brady Williams në SHBA, jeton me to dhe jeta e tyre shkon vaj. Të paktën me aq sa kjo familje tregon për mediat. Si është të jetosh në këtë lloj familjeje? Pra të bashkëjetosh me 5 gra? Fillimisht duhet t'ju themi se ndonëse për shumë njerëz është e papranueshme, ata thonë se janë të lumtur dhe gëzojnë respekt për njëri tjetrin. Brady dhe 5 shpirtrat e tij binjakë

## Të jetosh me pesë gra? Burri: Jeta jonë shkon "vaj"



kanë gjithsej 25 fëmijë. Ata festojnë me njëri, tjetrin, kanë një shtëpi të madhe,

kanë një jetë plot angazhime dhe gratë janë të lumtura me njëra-tjetrën.

1913 - U çlirua Struga dhe Ohri prej forcave serbe.

1923 - Oborrësia e Shkodrës dhe Malësia organizoi një miting të madh kundër sulmeve dhe provokacioneve të ushtrisë jugosllave. Mitingu iu drejtua me një protestë fuqive të Mëdha dhe Lidhjes së Kombeve ku kërkonte tërheqjen e trupave jugosllavë nga tokat shqiptare.

1924 - Fan Noli, Luigj Gurakuqi, Hasan Prishtina, Bajram Curri dhe Bedri Pejani morën pjesë në Lidhjen e pestë të Kombeve në Gjenevë. Atje përfaqësuesit e Kosovës kundërsh-tuan gjenocidin që ndiqte Beogradi ndaj popullit shqiptar në Kosovë.

1928 - Nënë Tereza e largua nga Shkupi në drejtim të Dublinit, në Irlandë. Prej kësaj dite nënë, bijë e motër nuk do të shiheshin më kurrë.

1925 - Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mërgimtarë shqiptarë nxorën numrin e parë të gazetës "Imigranti", organ i lirë i shqiptarëve të Amerikës. Ajo ishte fletore javore sho-qërore, kulturore dhe letrare në gjuhën shqipe dhe pjesërisht në anglisht.



### PSE DUHET TË KONSUMONI KAFE ÇDO MËNGJES

Shumica e njerëzve e kanë kafën e mëngjesit një zakon të pandashëm. Ka nga ata që nuk e nisin dot ditën nëse nuk akne shijuar filxhanin e kafes. Përgjithësisht, këshillohet që kafa të konsumohet pas vaktit të ushqimit. Por, a veproni mirë duke pirë kafën çdo mëngjes? Duhet të dini se ajo është shumë e mirë për shëndetin e zemrës. Konsumi i filxhanit të kafes çdo mëngjes ndihmon në funksionimin e mirë të zemrës. Madje, efekti është gjatë gjithë ditës në vijim.

### KANDIDATI PËR KRYEMINISTËR

- Alo, me Kryeministrinë po flas ?
- Po, me çfarë mund t'ju ndihmoj ?
- Doja të kandidoja për kryeministër, cilat janë kushtet?
- Je i çmendur ti!?
- Po kushte të tjera nuk ka??



Bota e thyen çdokënd, dhe më pas, disa janë të fortë te pjesët e thyera. (Ernest Hemingway)



KALENDARI HISTORIK 26 SHTATOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS